



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Inxhinieri e Naftës dhe e Gazit”

Universiteti Politeknik i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Gazmend Zeneli
2. Dr. Genti Kromidha

Dhjetor, 2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në
“Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”

1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave Departamenti i Burimeve të Energjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
4	Urdhri/VKM i licencimit:	-
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	Shkresë e MASR Nr 6883/2 prot., datë 21.09.2018*
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 154, datë 16.04.2021
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	Programi akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 i KKK
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2023-2024 – Total 42, nga te cilet 38 PAE dhe 4 PAK. Viti akademik 2022-2023 – Total 45, nga te cilet 41 PAE dhe 4 PAK. Viti akademik 2021-2022 – Total 45, nga te cilet 41 PAE dhe 4 PAK.
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2021-2022 – 40 studentë Viti akademik 2022-2023 – 28 studentë Viti akademik 2023-2024 – 28 studentë
19	Komente / të tjera:	-

*Shkresa e mësimperme miraton ndryshimet e bëra nga Institucioni sipas VSA Nr 8, datë 14.07.2017 “Për miratimin në masën 20% në përmbajtje, të shprehur në kredite, të programeve të ciklit të parë ‘Bachelor’, të ciklit të dytë ‘Master i Shkencave’”. Sipas kësaj shkrese programi i studimit Bachelor në “Inxhinierinë e Gjeoburimeve, profili “Inxhinieri e Naftës, Gazit dhe Ujit” riorganizohet në Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit.

9

CE

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit në proces të akreditimit për herë të parë të tij, Bachelor në "Inxhinieri e naftës dhe Gazit" është program i cili është riorganizuar. Sipas vendimit të Senatit akademik të UPT, Nr 8, datë 14.07.2017, është kërkuar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) riorganizimi i programit nga Bachelor në Inxhinierinë e Naftës, Gazit dhe Ujit" në Bachelor në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit. Me Shkresë të MASR Nr 6883/2 prot., datë 21.09.2018, programi i studimit riorganizohet në Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit". Me Urdhër të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) Nr 154, datë 16.04.2021 miratohet regjistrimi i formës së diplomës së këtij programi studimi.

Programi i Studimit ofrohet pranë Departamentit të Burimeve të Enegjisë (sipas dokumentit të Aplikimit në ASCAL nga UPT për këtë program). Ndërsa sipas RVB programi është fryt i bashkëpunimit dhe menaxhimit midis katër departamenteve të Fakultetit të Gjeologji Minerave: Departamenti i Burimeve të Energjisë; Departamenti i Shkencave të Tokës; Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikës dhe Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare.

I gjithë Raporti i Vlerësimit të Jashtëm të këtij programi është përqendruar në Dosjen e Vetëvlerësimit të dorëzuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi, në vizitën në Institucion dhe në takimet që kemi realizuar si Grup Vlerësimi. Në këtë Raport janë pasqyruar të dhënat që kanë dalë si rezultat i punës dhe i analizës së GVJ mbi procesin e vlerësimit të jashtëm.

Programi i studimit i përket ciklit të parë të studimeve Bachelor, nivelit 6 (gjashtë) në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, ofrohet në gjuhën shqipe, me një total prej 180 ECTS dhe zgjat 3 vite akademike.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Institucioni në dosjen e vetëvlerësimit tabela 6.3 e anekseve të RVB, në këtë program studimi japin mësim, për vitin akademik 2023-2024, gjithsej 42 personel akademik (PA), nga të cilët:

38 janë PAE (5 Prof. Dr; 10 Prof. Asoc; 11 Dr; 12 Msc)

4 janë PAK (1 Dr; 3 Msc)

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (pranime) në programin e studimit BSc në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit", referuar Tabelës 21 të të dhënave për këtë program studimi, dhe të dhënave të marra në Sekretarinë mësimore, është si më poshtë:

Viti akademik	<i>referuar Tabelës 21</i>	<i>Sipas të dhënave të marra në Sekretarinë mësimore</i>	
	Regjistruar	Regjistruar	Çregjistruar
2021 – 2022	40 studentë	40 studentë	-
2022 – 2023	28 studentë	28 studentë	-
2023 – 2024	28 studentë	28 studentë	-

Referuar tabelës Nr. 23, ku paraqiten të dhënat për studentët e diplomuar, rezulton se për periudhën 2021-2024 numri total i të diplomuarve është 130 studentë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësuesve të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga **Dr. Gazmend Zeneli** dhe **Dr. Genti Kromidha**. Koordinatorë Teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Anilda Beqiraj

GVJ mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) dhe vendosi realizimin e vizitës në Institucion më datë 27 Qershor dhe 28 Qershor 2024, për të cilën u hartua edhe Agjenda e vizitës me takimet përkatëse.

Në bazë të Agjendës, GVJ realizoi në Universitetin Politeknik të Tiranë takime me:

- Dekanin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave
- Përgjegjësin e Departamentit të Burimeve të Energjisë
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm
- Stafin akademik të angazhuar në program
- Përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve
- Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit dhe Drejtorinë e Kurikulave
- Studentët e programit BSc në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"

Gjithashtu GVJ realizoi një vëzhgim të mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.). Gjatë vizitës u vërejt që për shkak të rikonstruksionit të godinës së fakultetit, një pjesë e laboratorëve në shërbim të programit të studimit, nuk ishin funksionalë. Po kështu, edhe biblioteka e Fakultetit nuk ishte funksionale për shkak të rikonstruksionit.

Mbi bazën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV), informacionit të marrë gjatë takimeve të realizuara në Institucion, GVJ ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ).



Universiteti Politeknik i Tiranës është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19.11.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 38/57, datë 19.11.2024. Institucioni njofton në ASCAL më datë 03.12.2024, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 1005.1, datë 03.12.2024. *Kthim përgjigje mbi mbi DRVJ e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit".*

Përgjigje e GVJ në lidhje me shkresën e dërguar nga UPT për Draft Raportin e vlerësimit të jashtëm për programin në proces akreditimi, Bsc në "Inxhinieri e Naftës dhe e Gazit".

Grupi i vlerësimit të jashtëm, pasi u njoh nga Koordinatorja e ASCAL, me shkresën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave me Nr. 1005/1 Prot., datë 03.12.2024 me lëndë "Kthim përgjigje për dërgimin e Draft –Raportit të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit", pa me kujdes pikat për të cilat ka dhënë përgjigje duke i argumentuar Institucioni në lidhje me Draft RVJ.

GVJ përgjithësisht, edhe pse më pak rezerva, është dakord me komentet e Institucionit dhe për këtë qëllim bën ndryshimet përkatëse në Standardet II.3 dhe Standardin II.5



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”, është program studimi që ofrohet në Departamentin e Burimeve të Energjisë, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës. Programi i studimit është ofruar më parë me emërtimin Bachelor në “Inxhinierinë e Gjeoburimeve, profili “Inxhinieri e Naftës, Gazit dhe Ujit”. Programi i studimit, pas miratimit të ndryshimeve në masën 20% në përmbajtje të shprehur në kreditë, riorganizohet në Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit me shkresë të MASR Nr. 6883/2 prot., datë 21.09.2018. Ky është vlerësimi i parë i tij në kuadër të akreditimit. Sipas të dhënave në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), programi ofrohet në gjuhën shqipe, me 180 ECTS, zgjat 3 vite akademike. Sipas nenit 5 të Rregullores së programit të studimit, ky program realizohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren mësimore të UPT, Rregulloren e brendshme të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, të Departamentit të Burimeve të Energjisë dhe drejtohet nga Departamenti i Burimeve të Energjisë, si njësi bazë e këtij fakulteti. Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ashtu si edhe programet e tjera që ofrohen në UPT, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Sipas Rregullores së programit të studimit por edhe sipas bisedave dhe takimeve të zhvilluara nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) në Institucion, programi i studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit ka qëllim që të formojë ekspertë me njohuri të mjaftueshme për të mbuluar problemet në: shpimin e puseve në të gjitha fushat e mundshme; shfrytëzimin e vendburimeve hidrokarbure; menaxhimin e këtyre vendburimeve; nxjerrjen dhe transportin e hidrokarbureve; mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit; shfrytëzimin e vendburimeve ujore. Sipas Rregullores së Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, neni 1, ky Fakultet detyrë kryesore të tij ka arsimimin e specialistëve të lartë,



f

	formimin e shkencëtarëve të rinj si dhe kryerjen e aktivitetit kërkimor shkencor në fushat e shkencave të gjeologjisë, të burimeve minerare dhe të inxhinierisë së naftës, gjeomjedisit dhe drejtimit e lidhura me to. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, neni 2</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Siç e kemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, ofrohet pranë Departamentit të Burimeve të Energjisë (DBE). Sipas dokumentit në DVV, Strategjia e Fakultetit të Gjeologji Minierave (2018-2023), Fakulteti i gjeologji Minierave është shkolla e parë e lartë dhe unike në Shqipëri për përgatitjen e specialistëve për të gjitha degët e shkencave të industrisë minerare. Drejtimit e specialistëve në këto shkenca kanë pasur si qëllim zhvillimin e gjeologjisë shqiptare, në të gjitha fushat e saj: përgatitjen e specialistëve të minierave për hapjen, përgatitjen dhe shfrytëzimin e vendburimeve të mineraleve të dobishëm si dhe të specialistëve të shpimit dhe prodhimit të vendburimeve të naftës dhe të gazit. Misioni i Fakultetit të Gjeologji Minierave është: - Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si dhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; - Të ofrojë mundësi për të përfutur nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës - Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal - Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_009 - Strategjia e FGJM (2018-2023) I.1;I.2</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Sipas materialeve të sjella në Dosjen e Vetëvlerësimit, por edhe sipas takimeve që zhvilloi GVJ në Institucion, Grupi i vlerësimit të jashtëm është i bindur që Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ka stafin e duhur akademik për ofrimin e këtij programi studimi, shumë specifik. Nga 42 personel akademik në total që japin mësim në këtë program studimi, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë me titull dhe me gradë (26 PAE dhe 1 PAK), duke siguruar një mundësi tepër të mirë të një ofrimi sa më cilësor të mësimdhënies.

	Të njëjtën gjë nuk mund ta shprehim për laboratorët në funksion të këtij programi, pasi godina e fakultetit është në rikonstruksion dhe për këtë shkak nuk arritëm të shikonim bazën e plotë laboratorikë në dispozicion të tij.			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Sipas Rregullores së Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, si njësi kryesore e ofrimit të këtij programi studimi, objekt vlerësimi, ky Fakultet ofron programe të ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. GVJ ju komunikua se procesi i kodifikimit të programit është në proces nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, proces që po kalon çdo program studimi që ofrohet në arsimin e lartë në vend.			
Konkluzione	GVJ shprehet se ofrimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit Politeknik të Tiranës, me fushën akademike të njësisë kryesore të tij si Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, si dhe të njësisë bazë siç është Departamenti i Burimeve të Energjisë, duke synuar ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ashtu siç është shprehur edhe në raportin e vlerësimit të Brendshëm (RVB) por edhe sipas bisedave të zhvilluara nga Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm (GVJ) të këtij programi, Universiteti Politeknik i Tiranës si një nga institucionet e rëndësishme të arsimit të lartë publik në vend dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, si njësi kryesore e ofrimit të programit të studimit, Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, me një eksperiencë disa vjeçare, ofrojnë jo vetëm për këtë program studimi, objekt vlerësimi në kuadër të akreditimit për herë të parë të tij, por edhe për programet e tjera, marrëdhënie bashkëpunimi të frytshme dhe në funksion të programeve. Ky program studimi ofrohet në bashkëpunim edhe me Departamentet e tjera të FGJM dhe paraqitet si një program ndërdisiplinor.



(Handwritten signature)

	Referuar dokumentit të paraqitur në DVV, (REF_044 – Raporti i analizës mësimore Staf Departament) jepet një informacion për ngarkesën mësimore të realizuar nga stafi akademik në vitin akademik 2022-2023, të ndara sipas cikleve të studimit dhe parashikimin për vitin akademik 2023-2024. Sipas këtij materiali janë paraqitur të dhëna për çdo anëtar të Departamentit, lidhur me normën vjetore; ngarkesën totale të realizuar; orët e realizuara në ciklin e parë; orët e realizuara në ciklin e dytë; orët e realizuara në ciklin e tretë; si dhe ngarkesën sipas semestrave. Nga shpërndarja e ngarkesës rezulton se gjatë vitit akademik 2022-2023, në Departamentin e Burimeve të Energjisë janë realizuar gjithsej 313 orë mësimore mbingarkesë në auditor, ose mesatarisht 28.45 orë mësimore në auditor për personelin akademik efektiv. Mbingarkesa maksimale në auditor ishte 221 orë mësimore. <i>Referenca:</i> Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ vëren se në Dosjen e vetëvlerësimit janë paraqitur dokumente në lidhje me marrëdhëniet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të UPT për realizimin e objektivave të programeve të studimit që ofron ky Institucion. Referuar dokumentit 045 – Marrëveshjet Institucionale UPT, dhe dokumentit 048 – Marrëveshjet me industrinë dhe Institucione, janë paraqitur të dhëna për marrëveshjet institucionale të UPT, konkretisht: - Marrëveshje Institucionale me Universitetet vendase - Marrëveshje Institucionale me Universitetet e huaja - Marrëveshje Institucionale me kompani - Marrëveshje Institucionale me Institucione Shtetërore - Marrëveshje në kuadër të Erasmus + Për të gjitha marrëveshjet e listuara janë paraqitur fillimi i kohës së nënshkrimit të marrëveshjes dhe mbarimi i saj. Vërehet se Universiteti Politeknik i Tiranës, ndër vite, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Në shumicën prej tyre afati i kohëzgjatjes së marrëveshjes është i pacaktuar. E njëjta gjë nuk vërehet tek marrëveshjet e UPT në kuadër të Erasmus +. Sipas tabelës së paraqitur, UPT ka lidhur marrëveshje me 34 institucione të huaja në kuadër të Erasmus +. Nga 34 Institucionet e listuara, vetëm me UNIWA, Greqi, marrëveshja është e vlefshme deri në 2027. Edhe me Politecnico di Torino, marrëveshja është deri në vitin 2024. Referuar dokumentit 047 – Marrëveshjet me industrinë dhe Institucione janë paraqitur marrëveshje: - Marrëveshje me Bankers Petroleum Albania LTD - Marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjise - Marrëveshje me Shoqërinë Albpetrol <i>Institucioni duhet të ofrojë më shumë përvoja bashkëpunuese të cilat shërbejnë si në mobilitetin e stafit ashtu edhe të studentëve në programet e studimit që ofrohen.</i>

	<i>Referenca:</i> <i>Ref_045 - Marrëveshjet Institucionale</i> <i>Ref_047 - Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Referuar RVB por edhe dokumentacionit të DVV (Ref. 045 <i>Marrëveshjet Institucionale</i>), ashtu siç jemi shprehur edhe në Kriterin 2, konstatohet se ndër vite, me kompani dhe institucione janë lidhur gjithsej 55 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat me 42 prej tyre afati i bashkëpunimit është i pacaktuar. Ndërsa, sipas dokumentit 047, me Industrinë dhe Institucione janë paraqitur gjithsej 3. - Marrëveshje me Bankers Petroleum Albania LTD (afati i saj deri më 21.05.2022) - Marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjise (me afat të pacaktuar) - Marrëveshje me Shoqërinë Albpetrol (e lidhur më 13.02.2020, me kohëzgjatje 2 vjeçare, me të drejtë zgjatjeje) Nga një këqyrje e emrave të kompanive dhe institucioneve me të cilat janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit, vërehet se studentët e programit të BSc në Inxhinieri e naftës dhe Gazit mund të kryejnë praktikat profesionale në këto kompani apo institucione, pasi natyra e funksionimit të kompanisë mund ti vijë në ndihmë studentëve për të praktikuar njohuritë që kanë marrë gjatë studimeve në këtë program studimi. <i>Referenca:</i> <i>Ref_045 - Marrëveshjet Institucionale</i> <i>Ref_047 - Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Sipas një dokumenti që është paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit (Ref – 048 <i>Model kontrate për praktikën FGJM</i>) është paraqitur tip - kontratë për realizimin e praktikës mësimore të studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës. Sipas nenit 1 të saj, Qëllimi i kontratës, shkruhet shprehimisht: “<i>Kontrata e realizimit të praktikës profesionale lidhet midis “emri zyrtar i subjektit”, që është në rolin e Drejtuesit të Praktikës profesionale dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, me qëllim përgatitjen praktike të studentit praktikant për përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit nga ana e tij, në përputhje të plotë me programin e praktikës.</i>” Mendojmë se përdorimi i emrit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, në nenin 1, mund të jetë ndonjë lapsus i mundshëm i përzgjedhjes së kontratës tip, pasi në kokë të kësaj marrëveshje shkruhet Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave. Nuk ka ndonjë raport analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.



	Referenca: Ref_048 - Model kontrate për praktikën FGJM			
Konkluzione	GVJ shprehet se Universiteti Politeknik i Tiranës ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë të biznesit, në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. GVJ konstaton se Institucioni duhet të ofrojë më shumë përvoja bashkëpunuese të cilat shërbejnë si në mobilitetin e stafit ashtu edhe të studentëve në programet e studimit që ofrohen. Gjithashtu duhet të përgatisë raporte analitike për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të praktikave mësimore të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”, i ofruar nga Departamenti i Burimeve të Energjisë pranë UPT, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi. Përmendim këtu VKM. Nr. 41, datë 24.1.2018” Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar. Referenca: Ref_001 - Statuti i UPT Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e naftës dhe Gazit Ref_023 - Syllabusët e Lëndëve
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në	Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” ofron studime bazë në shkencat themelore në fushën e inxhinierisë dhe më specifike në atë të inxhinierisë së naftës dhe gazit natyror.

një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Në përfundim të këtij programi studimi synohet që i diplomuari të ketë njohuritë bazë teorike si edhe njohuritë më të thelluara të nevojshme për të qenë të aftë për punë ndërdisiplinore. Programi i studimit synon gjithashtu t'u japë studentëve njohuri shkencore dhe një përgatitje me spektër më të gjerë, veçanërisht në: • Shpimin e puseve në të gjitha fushat e mundshme; • Shfrytëzimin e vendburimeve hidrokarbure; • Menaxhimin e këtyre vendburimeve; • Nxjerrjen dhe transportin e hidrokarbureve; • Mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit; • Shfrytëzimin e vendburimeve ujore. Përmes kësaj synohet t'u ofrohen studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës duke u krijuar hapësira për punësuar në fushat e mëposhtme të aktivitetit ekonomik e administrativ. Në përfundim të këtij programi studimi diplomohen inxhinierë të cilët mund të ndërthurin formimin në Mekanikën e Fluideve në Mjediset Poroze, Inxhinierinë e Rezervuarit, Teknologjinë e Shpimit të Puseve, Nxjerrjes së Naftës, Transportit të Hidrokarbureve, Menaxhimit të Burimeve të Energjisë dhe Teknologjitë e Shfrytëzimit të tyre, Gjeomjedisit dhe Mbrojtjes nga ndotjet etj. si dhe të disiplinave shkencore të përafërta me to. Ky program studimi zhvillon një mënyrë të re të menduari për analizimin dhe zgjidhjen e problemeve inxhinierike, optimizuese dhe teknike në industrinë e naftës dhe gazit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë: - Lëndë bazë (A) – 37 ECTS – 20.5 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 94 ECTS – 52.2%, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 23 ECTS – 12.8 %, - Lëndë plotësuese (D) – 21 ECTS – 11.7 %, - Detyrime përmbyllëse (E) – 5 ECTS – 2.8 %. <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 – Plani mësimor iPS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Si pjesë e lëndëve karakterizuese (B) janë parashikuar kryerja e Praktikës lëndore/mësimore, gjithsej 4 ECTS (75 orë mësimore). Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 5 ECTS. <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 – Plani mësimor iPS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UPT dhe FGJM ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut. FGJM mbulon fushat didaktike dhe shkencore të Inxhinierisë së Naftës dhe Gazit”, Gjeologjisë së Zbatuar, Shkencave të Tokës, Inxhinierisë së Burimeve Minerare, Gjeoinformatikës, Topografisë, Pasurimit dhe Gjeomjedisit. Ndër të tjera misioni i FGJM është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të ndryshme; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushat e sipërcituara. Veprimtaria akademike e FGJM zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e Europiane. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 6. Programet e studimit “Bachelor”, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	UPT nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtesë. Nga informacionet që GVJ disponon, nisur nga fakti që programi i ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” ka një përmbajtje të veçantë dhe zhvillon një mënyrë specifike të menduari për analizimin dhe zgjidhjen e problemeve-inxhinierike, optimizuese dhe teknike në industrinë përkatëse, nuk ka ngjashmëri në përmbajtje në ofertën akademike në nivel kombëtar.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë	Diploma e programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” nuk ofrohet si diplomë e dyfishtë apo e përbashkët në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë.



Q

institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit" ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën përkatëse. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i> <i>UPT ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij janë të përcaktuara në Statutin dhe aktet e tjera të UPT. Njësia kryesore përgjegjëse për këtë Program Studimi është Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave, i cili përbëhet nga 4 njësi bazë, si më poshtë: 1. Departamenti i Burimeve të Energjisë; 2. Departamenti i Shkencave të Tokës; 3. Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës; 4. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare. ▪ Departamenti i Burimeve të Energjisë aktualisht ka një personel akademik prej 24 anëtarësh, prej të cilëve 4 Profesorë, 1 Prof.As, 4 Doktorë Shkencash, 2 Master Ekzekutiv dhe 13 Master i Shkencave, prej të cilëve 12 anëtarë PAE, 12 anëtarë PAK dhe 3 personel ndihmës akademik. [Tabela 1&2 Aneksat]; ▪ Departamenti i Shkencave të Tokës aktualisht ka një personel akademik prej 21 anëtarësh, prej të cilëve 10 Profesorë, 2 Profesor i Asociuar, 6 Doktorë Shkencash dhe 3 Master i Shkencave, prej të cilëve 12 anëtarë PAE, 9 anëtarë PAK dhe 4 personel ndihmës akademik. [Tabela 1&2 Aneksat]; ▪ Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës aktualisht ka një personel akademik prej 18 anëtarësh, prej të cilëve 5 Profesorë të Asociuar dhe 10 Doktorë Shkencash dhe 3 Master i Shkencave, prej të cilëve 14 anëtarë PAE, 4 anëtarë PAK si dhe 3 personel ndihmës akademik. [Tabela 1&2 Aneksat]; ▪ Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare aktualisht ka një personel akademik prej 19 anëtarësh, prej të cilëve, 3 Profesorë, 4 Profesorë të Asociuar,



8 Doktorë shkencash, 4 Master i Shkencave, prej të cilëve 11 anëtarë PAE, 8 anëtarë PAK dhe 3 personel ndihmës akademik. [Tabela 1&2 Aneksat].

Numri i personelit për çdo njësi baze për Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontrate (PAK), Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) për vitet akademike 2022-2023 dhe 2021-2022 është dhënë në tabelat e mëposhtme.

Viti akademik 2022-2023

Departamenti	PAE	PAK	Personel ndihmës Akademik	Total
Departamenti i Burimeve -të Energjisë	13	11	3	27
Departamenti i Shkencave të Tokës	11	9	3	23
Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës;	17	3	3	23
Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare	14	5	4	23
Ne total	55	28	13	96

Viti akademik 2021-2022

Departamenti	PAE	PAK	Personel ndihmës Akademik	Total
Departamenti i Burimeve -të Energjisë	12	11	3	26
Departamenti i Shkencave të Tokës	11	12	3	26
Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës;	16	6	3	25
Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare	15	7	4	26
Total	54	36	13	103

Referenca:

[Tabela 1, 2 dhe 6 Aneksat].

Ref_015 - Organigrama e FGJM

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për

Organizimi dhe menaxhimi i këtij programi studimi, si dhe programet e tjera të studimit të ofruar nga UPT, në nivel njësie bazë bëhet nga Këshilli i Programit të

programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Studimit (KPS), i cili ngrihet pranë njësisë bazë ose njësisë kryesore në rast të programeve të studimit ndërdisiplinore, ekzistuese ose të reja. 2. KPS-ja përbëhet nga 3 (tre) anëtarë për programet e studimit të ciklit të dytë, 5 (pesë) anëtarë për programet e studimit të ciklit të parë dhe 5 (pesë) -7 (shtatë) anëtarë për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë. Një anëtar përzgjidhet nga radhët e studentëve. 3. Anëtarët e KPS-së përzgjidhen nga departamenti përkatës. Drejtuesi i KPS-së është koordinatori i programit të studimit. Një element i rëndësishëm i koordinuar në kuadrin e praktikave profesionale është angazhimi në drejtimin e tyre të stafit më të ri akademik të FGJM, stafit ndihmës akademik si dhe ish studentët e diplomuar në programet e studimit; Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional të ofruara nga FGJM, të cilët punojnë në profesion. Ky kombinim ka rezultuar shumë sinjifikativ në drejtim të motivimit, njohjes së terrenit si dhe interesit për një punësim të mundshëm në këto kompani. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Koordinatori për programin e studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” është parashikuar në Rregulloren e Brendshme e DBE. Koordinatori i programit zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me rregulloren e e sipërcituar, ku përcaktohen qartë detyrat e tij. <i>Referenca:</i> <i>Ref_008 - Rregullorja e brendshme e DBE (Neni 21)</i>			
Konkluzione	Departamenti i Burimeve të Energjisë (DBE), si pjesë e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM), zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe standardet e cilësisë në Arsimin e Lartë, të reflektuara edhe në aktet rregullatore të Institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



f

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Burimeve të Energjisë, pranë Fakultetit të Gjeologji Miniera – UPT. DBE disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarrëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Fakultetit dhe të Departamentit. Programi mësimor i lëndës (syllabuse-t) hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Në të ka informacion të detajuar rreth lëndës dhe mënyrës së zhvillimit të saj. Dokument tjetër për realizimin e PS është dhe Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurat e UPT-së për zhvillimin dhe menaxhimin e programeve të studimit dhe të procesit mësimor në ciklin e parë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_007 – Plani Strategjik i FGJM</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ vëren se bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” ka Planin Mësimor i cili është i organizuar në vite akademike dhe semestral. Në të parashtrohen në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë vijon: a) emërtimi i programit të studimit, viti akademik, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për të, fusha e studimit, kohëzgjatja normale e studimeve, forma e përmbylljes së studimeve, struktura mësimore e programit të studimit; b) tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara në semestra dhe të renditura sipas semestrave; c) kreditet për ëdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një discipline sipas veprimtarive formuese të saj (leksione/ ushtrime/ seminare/ laboratorë/ detyra/projekte etj.), ngarkesa në auditor /jashtë auditorit, ngarkesa javore në auditor, mënyra e vlerësimit të lëndës. <i>Në Planin mësimor mungon kolona e orëve totale mësimore (llogaritur si: 1 ECTS=25 orë mësimore në auditor + punë e pavarur e studentit), si pasojë nuk tregohet sasia e orëve pune të pavarur të studentit për çdo lënd apo modul. Ndërsa në syllabuset e lëndëve jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit</i>




	<i>Referenca:</i> <i>Ref_011 – Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ vëren se programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kështu, Neni 19 i Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT jep informacionin dhe kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve. Ndërsa Kreu VI-të i kësaj rregulloreje përcakton gjithë procedurat e ndjekura lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve. Ndërsa Neni 11 i Rregullores së PS Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” përmban përveç kriterëve të përgjithshme edhe ato specifike për programin lidhur me kuotat dhe kriteret e pranimit në të. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ vlerëson se plani Mësimor i programit të studimit jep informacione të mjaftueshme rreth lëndëve që zhvillohen dhe strukturës së tyre. Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Tabela 14, Aneksët], hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit. Lëndë, praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Në programin mësimor të lëndës jepen në formë të përmbledhur: a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor, emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës; b) njohuritë paraprake që duhet të ketë fituar paraprakisht studenti, rezultatet e të nxënit të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvetësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda; c) përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore; d) përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave detyrave/projekteve të kursit; e) forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse.



	<i>Referenca:</i> <i>Ref_011 – Plani mësimor iPS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi i studimit është hartuar dhe përditësohet në vazhdimësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përvojave më të mira nga universitetet homologe europiane, ndryshimet e objektivave dhe strategji kombëtare, si dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e nxjerrejs dhe përpunimit të Naftës dhe Gazit. Procedura e rishikimit të programit të studimit në masën jo më shumë se 20% jepen të detajuara në Nenin 16 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të UPT. Plani mësimor hartohet/rishikohet nga KPS-ja, miratohet paraprakisht nga departamenti, kontrollohet dhe miratohet nga dekanati i njësisë kryesore, vlerësohet për plotësimin e standardeve nga Drejtoria e Kurrikulave dhe miratohet nga SAUPT para fillimit të vitit përkatës akademik. Evidentohet që ky program studimi nuk ka realizuar rishikim në masën mbi 20%. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_040 - Praktika e Miratimit të Planeve Mësimore</i>			
Konkluzione	Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit" përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit" është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, në përputhje me formimin e kërkuar në tregun e punës në këtë profil

mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar punësimin e shpejtë të studentëve brenda profilit të studimit. Sipas planit mësimor dhe syllabuseve përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe e praktikave mundësojnë njohuri bashkëkohore dhe atraktive për studentët, ato janë të organizuara sipas objektivave të formimit dhe mundësojnë marrjen e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe punësimin. Emërtimi i lëndëve që përmban ky program studimi, kategorizimi dhe shpërndarja e lëndëve dhe zhvillimi i praktikave që e shoqërojnë atë, janë të tilla që u mundësojnë studentëve të këtij programi studimi fitimin e njohurive dhe aftësive në fushën e inxhinierisë dhe më specifikisht në atë të “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Neni 2</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit është i organizuar në mënyrë të tillë që shpërndarja e lëndëve/moduleve në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite e orë mësimore të mundësojë arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Duke qenë program inxhinierie, ai është organizuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive të fituara në kurset teorike dhe fokusi mbetet në kombinimi e seancave të ushtrimeve, laboratorëve, detyrave dhe projekteve, praktikave lëndore dhe ato profesionale, si dhe tezave të diplomave. Nëpërmjet ndarjes në kredite të lëndës sipas aktiviteteve formuese të saj leksione/ ushtrime/ laboratorë/detyra dhe projekte/ praktikë lëndore bëhet e mundur të ruhet një raport proporcional ndërmjet aktiviteteve teorike dhe aktiviteteve praktike të saj. Programi i studimit në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” ka objektiva të shprehura qartë, në funksion të përvetësimit të dijeve dhe formimit të kompetencave profesionale të studentëve që lidhen me programin. Objektivi kryesor tu japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe më specifikisht në atë të “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”. Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që fitohen të jenë në vijimësi të njëra-tjetrës Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë: - Lëndë bazë (A) – 37 ECTS – 20.5 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 94 ECTS – 52.2%, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 23 ECTS – 12.8 %, - Lëndë plotësuese (D) – 21 ECTS – 11.7 %, - Detyrime përmbyllëse (E) – 5 ECTS – 2.8 %.

	Në pjesën më të madhe të lëndëve inxhinierike aplikohen detyra kursi, laboratorë të cilat synojnë të zhvillojnë aftësitë komunikuese të studentëve dhe nxisin që ata të përvetësojnë procesin e kërkimit dhe të aftësimit profesional. Analizat mësimore vjetore të Departamentit japin informacione më të detajuara mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional, etj. <i>Mendojmë se ka pak hapsirë për praktika profesionale në terren fizik, ku studentët fitojnë njohuri dhe fitojnë aftësi praktike konkrete.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Neni 8</i> <i>Ref_011 – Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i> <i>Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” është strukturuar në përputhje me praktikën ndërkombëtare, duke u mbështetur kryesisht në modelin e umiversitetit Politeknik të Torinos. Po ashtu është ndjekur edhe modeli i Montanuniversitat Leoben - Austri. Përvoja ndërkombëtare e strukturës së këtij programi studimi është përshtatur më së miri me aktet ligjore e nënligjore të arsimit të lartë në Shqipëri. BING, në strukturën e tij është në përputhje me dispozitat e VKM Nr 41. datë 24.01.2018, “Për Elementët e Programit të Studimit”, ku pesha dhe ngarkesa e veprimtarive formuese, e shprehur në kredite është në përputhje me veprimtaritë formuese të parashikuara për programet e studimit të ciklit të parë, të pasqyruara në shtojcën Nr 1, të kësaj VKM-je. Lëndët në programin mësimor përmbajnë aspekte teorike (leksione) dhe aspekte praktike (seminare, ushtrime, laboratorë), ku për pjesën më të madhe të lëndëve raporti teori: praktikë është në vlerat 50:50%. Nga analizat vjetore e periodike të punës mësimore në FGJM, rezulton se programi ka një ngarkesë të plotë mësimore dhe raport të ekuilibruar teori - praktikë e cila është në përputhje me profilin e programit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” dhe krijon mundësi profilizimi të studentëve në fushën e “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”. <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 – Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament</i> <i>Ref_045 - Marrëveshjet Institucionale</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik	GVJ vlerëson se në këtë program studimi, ndarja sipas veprimtarive formuese është në përputhje të plotë me VKM Nr 41. datë 24.01.2018, “Për Elementët e Programit të Studimit”.

dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e veprimtarive formuese e cila jepet e detajuar në planin mësimor dhe e përcaktuar në syllabuset e lëndëve dhe moduleve një raport teori - praktikë i ekuilibruar ndërmjet tyre, krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, sipas drejtimit dhe profilizimit dhe objektivave formues të programit, gjë e cila u mundëson atyre transferimin e studimeve në institucione të tjera. Tregues së arritjes së objektivave formues, janë numri i regjistrimeve në këtë program [Tabela 21 Anekset] dhe numri i të punësuarve në përputhje me diplomën [Tabela 23 Anekset]. <i>Gjithsesi mendojmë se ka pak hapsirë për praktika profesionale ne terren fizik, ku studentët fitojnë njohuri dhe fitojnë aftësi praktike konkrete.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 – Plan i mësimor i PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Departamenti i Burimeve të Energjisë kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Përditësimi i programeve lëndore e tyre duke u bazuar në literaturën më të re bazë dhe ndihmëse ky preferohen botimet e 5 viteve të fundit është objekt i diskutimeve të vazhdueshme. Bashkëpunimi dhe mundësia e hyrjes në bibliotekat e fushës së inxhinierisë ka mundësuar përditësimin e literaturës. Me hapjen e bibliotekës elektronike u bë një njohje e stafit akademik dhe studentëve me website-in e RASH dhe mënyrën si të regjistrohen në të: [https://ulibrary.rash.al/bibliotekadigjitale, Tabela 17] Gjithashtu stafi dhe departamentet çdo vit bëjnë porosi në Bibliotekën Shkencore të UPT ose kërkojnë në buxhetin e FGJM të blejnë literaturën përkatëse të lëndëve të tyre. Eksperiencat, në bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe mobilitetet e stafit akademik të FGJM ne periudhën 2021 - 2024 në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve. <i>Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të bëra, akoma ngelet punë për tu bërë në përditësimin e syllabuseve, sidomos në lëndët e karakterit jo-teknik.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Ref_045 - Marrëveshjet Institucionale</i> <i>Ref_047 - Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione</i> <i>Ref_061 - Mobilitetet e realizuara 2021-2024</i>

	<i>Ref_067 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2021-2024</i> <i>Ref_094 - Praktikë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore-bazë</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Duke ju referuar syllabuseve të lëndëve tek pjesa “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxëniet” evidentohet që programi i studimit “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” ka përmbajtje didaktike, profesionale dhe shkencore formuese dhe garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli “Bachelor”. Ato përbëjnë edhe synimet kryesore të këtij programi të përcaktuara edhe në Rregulloren e studimeve të programit. Programi i studimit “Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” synon që të formojë inxhinierë të kësaj fushe që të kenë kompetenca në; bazat e hartimit të Projekteve Infrastrukturore të Transportit dhe Magazinimit të Naftës dhe Gazit, përfshirë sistemet e mbrojtjes dhe të dërgimit të informacionit në kohë reale; Bazat e hartimit të Planeve Zhvillimore të Vendburimeve Hidrokarbure; Bazat e Modelimit të Vendburimeve Hidrokarbure; Bazat e Projektimit të Puseve të Shpimit për të gjitha etapat e shfrytëzimit të Vendburimeve Hidrokarbure (duke filluar nga puset e Kërkim — Zbulimit deri te ato të Injektimit); Bazat e Projektimit të Lëngjeve Larës; Mekanikën e Fluideve dhe Ligjësive të Filtrimit të Fluideve jo-Njutoniane; Bazat e Inxhinierisë së Rezervuarit, Regjimeve Natyrore, Llogaritjes së Rezervave dhe Koeficientit të Shfrytëzimit të Vendburimeve Hidrokarbure. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” u mundëson studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave, për t’u punësuar në fushën e Naftës dhe Gazit, në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në përputhje me profilin e studimit. Ky program studimi i jep të diplomuarit në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” kompetenca profesionale të mjaftueshme për tu punësuar në Shoqëritë private të shfrytëzimit të vendburimeve të naftës dhe gazit dhe industrinë e përpunimit të tyre në Shqipëri dhe jashtë saj. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Neni 8</i>
Konkluzione	<i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturën bashkëkohore, duke mundësuar</i>

	integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë «Master Profesional» dhe «Master i Shkencave».			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, nga FGJM dhe DBE organizohen analiza të mësim-dhënies dhe punës shkencore në funksion të tij, në të cilat shqyrtohet ecuria dhe zbatimi i programit si dhe çështje të tjera që lidhen me ecurinë e mëtejshme të studentëve. Organizimet e takimeve në terren të stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve me administratorë dhe drejtues të sipërmarrjeve në fushën e inxhinierisë së naftës dhe gazit, po kështu edhe ish-studentëve të punësuar në këtë sektor, janë një ndihmesë e mirë për të marrë propozimet e tyre për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Me qëllim formalizimin e këtyre aktiviteteve dhe marrjen e një mendimi sa më institucional si dhe me iniciativën e disa profesorëve emeritus të FGJM në UPT, është krijuar Shoqata Alumni/ae e FGJM. Propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës, janë një ndihmesë në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. <i>Referenca</i> <i>Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të	Në fund të çdo semestri zhvillohet anketimi i studentëve dhe hartohet Raporti i Anketimit Studentor gjatë vitit akademik. Ky raport përgatitet nga Njësia Qendrore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për secilin prej programeve të studimit të ofruara në UPT si dhe për secilën lëndë/modul të këtyre programeve. Vlerësimi i kryer është objekt diskutimi dhe reflektimi mbi përfundimet e dala nga raporti në njësinë bazë dhe që përfaqëson një feedback me kontributin e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit për të cilin është kryer pyetësori. Të dhënat e këtyre raporteve gjithashtu



përmirësimit të programit të studimit.	përbëjnë një bazë të dhënash për hartimin e raporteve të analizës mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti. <i>Referenca:</i> <i>Ref_060 – raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 (Sem. I)</i> <i>Ref_096 - Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në Kreun IX të Statutit të UPT-së përshkruhen procedurat e për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBC-së, në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UPT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Gjithashtu përfshirja e stafit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentëve në proceset e akreditimit shërben për ndërgjegjësimin dhe krijimin e një kulture lidhur me sigurimin e cilësisë. Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. <i>Mendojmë se nisur nga misioni i saj kjo Njësi ka ende shumë për të bërë, për përmbushjen e misionit të saj mbështetur edhe në rekomandimet e bëra nga ASCAL në përfundim të procesit të akreditimit institucional.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_019 - Urdhër i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB</i> <i>Ref_060 – raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 (Sem. I)</i>
Konkluzione	<i>Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike, megjithëse ka shumë për të bërë në zgjerimin e veprimtarive të përbashkëta me botën e biznesit dhe operatorët në fyushën e naftës dhe gazit. Këto lloj veprimtarish synojnë të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional të ardhshëm.</i> Do të sugjeronim: 1. Në Planin Mësimor të parashikohen dy kollona me të dhëna me orët mësimore në përgjithësi që parashikon sasia e krediteve ECTS (1 ECTS=25 orë mësimore) për çdo lëndë/modul dhe në total, me qëllim evidentimin e sasisë së orëve mësimore pune, jashtë auditorit (për studim) që i duhet një studenti (Kollona e dytë). Këto



	<i>të fundit shërbejnë për llogaritjen e raportit orë mësimore në auditor/jashtë tij.</i> 2. Sipas Planit Mësimor nuk parashikohet Praktikë Profesionale në terren fizik pranë institucioneve, sipërmarrjeve ku studentët fitojnë njohuri dhe fitojnë aftësi praktike konkrete të jetës. Në Plan praktikës i është lënë vetëm ECTS = 75 orë mësimore (mendojmë e pamjaftueshme). Të jepen argumentet pse të gjithë studentët i përfundojnë studimet me punim diplome (megjithëse në Rregullore pranohen të dy mundësitë)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV shikohet që për mësimdhënien dhe mësimnxënien në këtë program studimi aplikohen forma të ndryshme të transmetimit të dijeve sikurse leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura, etj., Kështu, ngarkesa në auditor e studentëve është e organizuar në leksione (1128 orë), seminare/ushtrime (798 orë), laboratorë (190 orë), forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (54 orë), praktikë profesionale (75 orë), gjithsej 2270 orë. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimi dhe të kontrollit të dijeve, të parashikuara në planet mësimore, në programet e lëndëve dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve e njohurive të përfshira në PS Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit" jepen të detajuara në planin mësimor dhe syllabusin e lëndës. <i>Referenca:</i> Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Neni 12



Handwritten signature in blue ink.

	<i>Ref_011 – Plani mësimor iPS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësim nxënies.	Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet në vijimësi diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veganti. Disa nga këto metoda janë zhvillimi i mësimi “E-Learning” si një mënyrë elektronike e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga ana e stafit akademik ka shëmbuj të zëvendësimit të materialeve në hardcopy me link-e, prezantime në PowerPoint, video, audio teste, animacione, forume, etj. Gjithashtu personeli akademik vazhdimisht përmirëson programet e lëndëve duke alternuar metoda të ndryshme mësimdhënie si dhe duke iu përshtatur nevojave të studentëve. Pjesa më e madhe e moduleve të programit, sidomos ato profesionale, përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik si dhe aftësinë e të punuarit në grup. <i>Mendojmë se, mësimdhënia në programin e studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” kërkon një kombinim më efektiv të njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale, e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Ref_062 – Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	UPT ka mbështetur vazhdimisht personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, kjo dëshmohet edhe nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit me institucionet homologe jashtë dhe brenda vendit të nënshkruara. Objekti kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin: shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve etj.; shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) kanë shërbyer përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike. Gjithashtu FGJM mbështet financiarisht trajnimin në universitete homologe europiane me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike dhe shkencore.

	Një pjesë e auditorëve mësimore janë pajisur me mjete audio-vizive. Gjithashtu në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve janë dhe laboratorët e shumtë që disponon FGJM dhe fakultetet e tjera të UPT. Gjate vizites qe GVJ realizoi në mjediset e FGJM, u vërejt që për shkak të rikonstruksionit të godinës së fakultetit, një pjesë e laboratorëve në shërbim të programit të studimit, nuk ishin funksionale <i>Referenca:</i> <i>Ref_045 - Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref_049 - Informacion laboratorët DBE</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik, i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon, i përket kategorisë profesor, doktor dhe Msc., si dhe me angazhim në punën kërkimore shkencore [Tabelat 1, 2 & 6 Aneksat]. Kompetencat dhe kualifikimi i stafit akademik jepet në CV e tyre. Njesia bazë planifikon ngarkesën mësimore sipas udhëzimeve përkatëse. Punesimi i personelit akademik efektiv apo me kontratë realizohet konform Ligjit Nr 80/2015, Neni 64, pika 1, Neni 57, pika 2, si dhe procedurave perkatëse për rekrutimin e stafit akademik. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_024 - CV e stafit akademik</i> <i>Ref_051 – Procedura e punesimit të Personelit PAE në UPT</i> <i>Ref_052 – Procedura e punesimit të Personelit PAK në UPT</i> <i>Ref_063 _ Praktike punësimi staf akademik FGJM</i>
Kriteri 5. Njesia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	DBE kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Mënyra e vlerësimit të formave dhe të metodave të mësimdhënies nga studentet fillon direkt në auditor duke diskutuar me ta në lidhje me elemente të veçantë të paraqitjes së tij dhe të përmirësimeve eventuale për metodat e mësimdhënies, Një rëndësi të veçantë kanë sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit. Mënyra kruesore për tërheqjen e mendimeve të studentëve është organizimi i pyetësorëve mbi vlerësimin e procesit mësimor. Mendimet dhe sugjerimet e tyre reflektohen në vijimësi. Mbi bazën e tyre titullari dhe stafi i angazhuar në mësimdhënie propozojnë ndryshime në programin e lëndëve. Në fund të çdo viti akademik, stafi raporton në mënyrë analitike e të detajuar mbi veprimtaritë akademike të realizuara gjatë vitit, ku ndër të tjera raporton mbi ndryshimet e mundshme të bëra në përmbajtje dhe metodat e mësimdhënies.

	<i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UPT-ja është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë (më poshtë siguri i cilësisë) në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë, funksionon Rrjeti i Cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), e ngritur në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), në çdo njësi kryesore të UPT-së. NJSBC ngrihet në njësinë kryesore dhe mbulon çdo program studimi dhe kërkimishkencor, që njësitë bazë të asaj njësie kryesore e ofrojnë/kryejnë. Organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimi, në UPT, në nivel njësie bazë bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili ngrihet pranë njësisë bazë ose njësisë kryesore në rast të programeve të studimit ndërdisiplinore, ekzistuese ose të reja. Drejtuesi i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënësve të tij. Koordinatori i programit të studimit informon vazhdimisht përgjegjësin e njësisë përkatëse për të gjitha problematikat. Organizimi i procesit mësimor në leksione, seminare, laboratore, etj i jep mundësi stafit të zhvillojë diskutime duke e bërë tërheqëse të medimit nga studentet, Keto rezultate reflektohen edhe në raportet e anketimeve të studenteve. Një nga format kryesore të inkurajimit të autonomisë së studenteve janë detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat e zhvilluara prej tyre në ndërmarrje si dhe prezantimet që ata përgatisin si pjesë e këtyre detyrimeve. Një formë efektive komunikimi bëhet nepermjet komunikimit elektronik përmes postës elektronike zyrtare personale (emer.mbiemer@fgjm.edu.al) të pedagogëve dhe studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Ref_060 – raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 (Sem. I)</i> <i>Ref_062 – Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i>
Konkluzione	<i>UPT dhe DBE kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda</i>

	<i>bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Format e kontrollit të dijeve janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim. Qëllimi është përcaktimi i rregullave dhe mënyrës së realizimit të kontrollit të dijeve për të arritur në një vlerësimi objektiv dhe të paanshëm të studentit. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimi. Me qëllim përcaktimin e mënyrës së kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është hartuar dhe miratuar “Procedura e Kontrollit dhe Vlerësimit të Dijeve në FGJM”. <i>Referenca:</i> <i>Ref_037 - Procedura per Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Personeli akademik pjesë e programit “Bachelor”, në fillim të çdo lënde/moduli informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përputhje të plotë me Rregulloret e UPT, FGJM dhe atë të programit të studimit në fjalë. Në programin e lëndës/modulit shprehen mënyrat e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentit me fillimin e procesit mësimor. Kriteret e vlerësimit përcaktohen nga titullari i lëndës dhe pasqyrohen në programin e lëndës. <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga shqyrtimi i dokumnetacionit në DVV, shikohet që testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Në kontrollin e vazhdueshëm, para provimit përfundimtar përdoren instrumente të tilla si: - Detyra Kursi; - Projekte Kursi; - Provime të ndërmjetme (testimeve gjatë semestrit); - Kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike. Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) mund të bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në



	programin mësimor. Pedagogu i lëndës i komunikon studentit, në orën e fundit të mësimi: - të drejtën e futjes ose jo në provim; - nivelin e pikëve të fituara në format e tjera të kontrollit të vazhdueshëm. - kriteret e vlerësimit përfundimtar. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyrë në vlerësimin përfundimtar, detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, përcaktohen në syllabus-in e lëndës së hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs në fillim të procesit mësimor. <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Ref_037 - Procedura për Vlerësimin e Dijëve në FGJM</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, konkretisht në Nenin 35 të saj, trajton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. Kjo rregullore trajton edhe garantimin e së drejtës së studentit për ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijes sipas procedurës së përcaktuar. Perpos sa me sipër, UPT garanton përfshirjen dhe pjesëmarrjen e studentëve në procesin e anketimit për çdo lëndë Kreu XII i Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT trajton të drejtën dhe procedurat e ankimimit, lidhur me shkeljen e standardeve akademike, procesit të mësimdhënies, etikës akademike, konfliktit të interesit apo çdo shkeljeje tjetër që çënon integritetin apo të drejtat e studentëve. Nëpërmjet anketimeve ku përfshihen të gjithë indikatorët e mësimdhënies, çdo studenti i jepet mundësia të shprehet mbi procesin mësimor dhe Stafin Akademik. FGJM realizon procesin e anketimit studentor për vlerësimin e çdo lënde në fund të semestrit përmes Platformës së Sekretarisë Mësimore: BIT ALBANIA në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH) i cili menaxhon këtë platformë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_060 – raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 (Sem. I)</i> <i>Ref_096 - Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të	Fakulteti i Gjeologji – Minierave dhe departamentet përbëres të tij, në fundim të çdo viti akademik bëjnë analizën e punës së tyre mësimore. Përmes analizës, përcaktohen edhe objektivat për përmirësimin e performancës së personelit dhe të cilësisë në mësimdhënie. Procedura e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme përsëritet në fillim të çdo viti akademik në njësitë bazë dhe të dhënat mbi

nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	performancën e stafit, të referuara nga titullarët e lëndëve dhe të grupeve mësimore, janë treguesi kryesor për vlerësimin që shërben edhe për rinovimin e kontratave. Gjithashtu, prej vitit 2018, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka kryer rregullisht edhe anketimin semestral studentor mbi cilësinë në mësimdhënie. Pyetësi i hartuar plotësohet nga studentët për çdo pedagog duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës nga studentit. Rezultatet e pyetësorit për çdo pedagog i përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët. Ndërkohë, përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. DBE vendos në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve infrastrukturën e nevojshme teknologjike për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies me qëllim realizimin e objektivave formues të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës. Përfshirja e studentëve, nën mbikqyrjen e pedagogëve të lëndëve, në rindërtimin e situatave reale në laborator përmes pajisjeve laboratorike në dispozicion, i aftëson në profesion dhe inkurajon sensin e tyre të autonomisë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament</i> <i>Ref_052 – Procedura e punesimit te Personelit PAK në UPT</i> <i>Ref_060 – raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 (Sem. I)</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/	Kontrolli i dijes në një lëndë bëhet në mënyrë të vazhdueshme, i shtrirë përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës. FGJM për vlerësimin e njohurive ka hartuar dhe zbaton një procedurë të vecantë, qëllimi i të cilës është përcaktimi i rregullave dhe mënyrës së realizimit të kontrollit objektiv të dijeve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Përcaktimi i raportit ndërmjet vlerësimeve të vazhduar dhe përfundimtar bëhet nga pedagogët në fillim të vitit akademik dhe miratohet nga drejtuesi i departamentit. Format kryesore të kontrollit të vazhduar për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të lëndës janë: detyrat e kursit, projektet e kursit, testimet e ndërmjetme dhe shlyerja e laboratorëve. Provimi final, sipas përcaktimeve në syllabus, organizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Ref_037 - Procedura per Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UPT, aktualisht, nuk ka në zbatim një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve avantazhet e të cilit do të rrisin transparencën dhe mundësonin reduktimin në maksimum të abuzimit dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve. Në platformën elektronike BIT ALBANIA, hidhen rezultatet e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar, duke informuar studentët në kohë reale për rezultatet e tyre dhe duke rritur transparencën. <i>Referenca:</i> <i>Ref_039 – Manual perdorimi platforma e Sekretarisë Mësimore Bit-Albania</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Studentët vlerësohen në provimin e lëndës nga një komision i vlerësimit me jo më pak se dy pedagogë: lektori i lëndës dhe pedagogë të tjerë të përfshirë në mësimdhënien e lëndës. Komisionet e provimit të lëndës ngrihen nga Drejtuesi i Departamentit dhe i dërgohen Dekanatit për informim, jo më vonë se një javë nga fillimi i sezonit të provimeve. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_037 - Procedura per Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i> <i>Ref_093 - Praktika të Propozimit të Komisioneve të Provimit</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë procesit të vlerësimit të gjithë elementëve të një moduli si: testi i ndërmjetëm, detyra e kursit, laboratorët ose provimi final etj.; stafi akademik bën komente gjatë korrigjimit në fletore në rastin e provimeve me shkrim ose komente direkte në rastin e provimeve me gojë apo detyrave/projekteve të kursit, të cilat ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive si dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë këtij procesi. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit.

	Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës ("Fleta e provimit"). Studenti ka të drejtë të sqarohet për ëdo paqartësi nga ana e tij ose të paraqesë pretendimet e tij për rezultatin e marrë. Studenti ka të drejtë të ankohet. Ankesa depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, brenda një afati prej 3 ditësh pune nga shpallja e rezultatit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_037 - Procedura per Vlerësimin e Dijeve në FGJM (pika 11.13)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 34, pika 7 si dhe Procedura e Vlerësimit të Dijeve në GJM, pika 11.10 përcaktohen veprimet e ndaluara gjatë zhvillimit të provimit përfshirë edhe kopjimin në provim. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës së UPT-së. <i>Referenca:</i> <i>Ref_003 – Kodi i etikes (Neni 6 dhe 9)</i> <i>Ref_037 - Procedura per Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi Pedagogun. Provimet e studentëve ruhen në departament nga lektori për një periudhë, të paktën deri në sesionin pasardhës të provimeve. Gjithashtu stafi akademik ka për detyrë të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese, të pamërituara prej tyre apo favore e përfitime të tjera, të cilat anëtar i personelit mund t'i ketë për shkak të detyrës [Neni 5, pika 16]. <i>Referenca:</i> <i>Ref_003 – Kodi i etikes</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,	Studentët kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi nga ana e komisionit ose të kundërshtojnë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Studenti ka të drejtë të ankimohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord



rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	me vlerësimin e bërë. Ankesa depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, brenda një afati prej 3 ditësh pune nga shpallja e rezultatit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Neni 35.</i> <i>Ref_037 - Procedura per Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtë të sqarohet për cdo paqartësi nga ana e tij ose të paraqesë pretendimet e tij për rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar pergjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM. Cdo ankesë nga studentët për vlerësimin në provime shqyrtohet nga Dekani dhe Zv. Dekan per veprimtarine mesimore, te cilët mund të thërrasin për sqarime drejtuesin e departamentit përkatës, komisionin e vlerësimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të cështjes, merret vendim i formes së prerë, brënda tri ditëve pune. Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar dhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_037 - Procedura per Vlerësimin e Dijeve në FGJM. Pika 11 dhe 13.</i>			
Konkluzione	<i>Ne rregulloret e FGJM, DBE dhe të programit të studimit përcaktohen procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit.</i> <i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë	Strukturat përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UPT janë Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [http://upt.al/cilesia-ne-upt] dhe Drejtoria e Kurrikulave

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

profesionale dhe të veçanta të studentëve.	[http://upt.al/dega_mesimore]. Keto dy struktura, së bashku me DBE janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit, si dhe në përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe përsosjen e metodave të mësimdhënies, elementë të cilët i nënshtrohen një vlerësimi periodik nga njësitë bazë dhe studentët. DSBC vendos lidhje bashkëpunimi me dekanët, drejtorët e instituteve, drejtuesit e programeve të studimit, përgjegjësit e departamenteve dhe organizatat studentore të UPT. Në këtë kuadër kërkohet të garantohet që diploma “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” të formojë ekspertë me njohuri të mjaftueshme dhe kompetenca për të mbuluar problemet në: Shpimin e puseve në të gjitha fushat e mundshme; Shfrytëzimin e vendburimeve hidrokarbure; Menaxhimin e këtyre vendburimeve; Nxjerrjen dhe transportin e hidrokarbureve; Mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit; Shfrytëzimin e vendburimeve ujore, etj. <i>Referenca:</i> <i>Ref_005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Natyrë e kompetencave të kërkuara në programin e studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit duke qenë se sektori i naftës dhe gazit është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar dhe zhvillimet globale në kërkim shkencor dhe gjeopolitikë, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit. Për këtë qëllim programi i Studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamenteve të FGJM që mbulojnë këtë program studimi, konkretisht: DBE, DSHT, DGJ IBM si dhe në përputhje me Strategjinë e FGJM. Programi i ciklit të parë të Studimit Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” organizohet dhe menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS). Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë për këtë program studimi. Shkëmbimet e kryera në kuadër të projektit ERASMUS+ i shërbejnë edhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies, cilësisë së programit të studimit dhe dimensionit social në to. Opinioni i studentëve mbi programet e studimit dhe lëndët që ata ndjekin janë një burim shumë i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike/ ndihmës akademike dhe programeve mësimore që ofron universiteti.

	FGJM ka si objektiv rritjen e kapaciteteve të tij akademike dhe laboratorike duke i dhënë nxitje të mësuarit kreativ dhe njëkohësisht rritjen e bashkëpunimit në projekte shkencore me partnerët e vet ndërkombëtarë. Krijimi i një mjedisi sa më social në shërbim të studentëve. Këto krijojnë nevojën e përhershme për përmirësime të mëtejshme në fushat e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_007 – Plani Strategjik i FGJM</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Neni 3 dhe Neni 18</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimet me studentet, u evidentua që FGJM zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet, zhvillimin e procedurave për monitorimin dhe rishikimin e cilësisë akademike, dhe menaxhimin e institucionit, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron. Gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara. Stafi akademik në FGJM është gjithmonë i vëmendshëm në marrjen e informacionit të përditësuar në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies. Kështu stafi akademik ka autonomi të plotë në hartimin e syllabuseve të lëndëve duke u inkurajuar të implementojnë vazhdimisht metodologji të reja mësimdhënie të cilat përmirësojnë cilësinë e saj. <i>Referenca:</i> <i>Ref_002 – Plani Strategjik i UPT</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të	Kurrikula e programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e detarisë. Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. Bashkëpunimet e DBE në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere.

përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik i FGJM i angazhuar në mbulimin e lëndëve të planit mësimor të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”, kualifikohet në mënyra të vazhdueshme sipas fushave të kërkimit shkencor individual [Tabela 1 & 2 Aneksit]. Ky proces aktualisht është bërë falë edhe suportit të institucionit, i cili ka mbështetur financiarisht dhe jo vetëm në pjesëmarrjen e stafit në projekte, seminare, trajnime, workshop-e, konferenca shkencore, etj. Mobilitetet e mundësuar prej projekteve ERASMUS+, është një mënyrë shumë e mirë për stafin akademik dhe studentët, për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të tjera si dhe të njohjes me arritjet bashkëkohore në institucione e universitete të tjera. <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Ref_045 - Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref_047 - Marrëveshjet me industrinë dhe Institucione</i> <i>Ref_061 - Mobilitetet e realizuara 2021-2024</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	DBE zhvillon vazhdimisht leksione të hapura me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjell tek studentët zhvillimet më të fundit. Gjatë viteve të fundit, është bërë një përpjekje e madhe nga stafi akademik e ndihmës akademik për përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies. Stafi akademik përdor një sërë instrumentash për testimin e efektivitetit të metodave të reja të aplikuara në mësimdhënie si: feedback i drejtpërdrejtë i marrë nga studentët në auditor; rezultatet akademike të studentëve; tabelat e krahasimit të rezultateve vjetore. Një tregues i qartë për këto metoda është përdorimi i platformave e-learning gjatë dhe pas periudhës së COVID-19. Rezultatet e kësaj pune stafi i raporton periodikisht cdo fund viti akademik përmes raportit të analizës mësimore të tij tek drejtuesi i departamentit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament</i> <i>Ref_070 - Raporti aktivitetit të Kërkimit shkencor pedagog departament FGJM</i> <i>Ref_079 - Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies 2021-2022</i>			
Konkluzione	Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e studimit. GVJ konstaton se pjesëmarrja e studentëve në kërkim shkencor është në nivele të ulta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kriteret të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar. Me “qëllim vendosjen e kushteve për mënyrën e konceptimit, formulimit dhe mbrojtjes të Punimit të Diplomës, në programet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në FGJM është hartuar dhe zbatohet “Konceptimi dhe Mbrojtja e Diplomës për Programet e Ciklit të Parë të Studimeve në FGJM”. Kjo procedurë zbatohet nga Departamentet që mbulojnë një program studimi, dhe nga studentët diplomantë në periudhën e përgatitjes së temës të Punimit të Diplomës dhe gjatë mbrojtjes së tij. <i>Referenca:</i> Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit Ref_055 - Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Nga takimi me studentet e programit BING, doli qartësisht që strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Kështu, në Procedurën e Konceptimit dhe Mbrojtjes së Diplomave përcaktohen përgjegjësitë e secilës strukturë lidhur me realizimin sa më me sukses të këtij procesi të rëndësishëm. Keto përgjegjësi janë: 1) Dekani i FGJM është përgjegjës për të kontrolluar nëse kjo procedurë zbatohet konform rregullave. 2) Drejtuesi i departamentit përgjegjës për krijimin e fondit të temave, ngritjen e komisionit të mbrojtjes dhe kontrollin përfundimtar të punimit të diplomës. 3) Udhëheqësi i punimit të diplomës ka përgjegjësinë e drejtimit të punës për realizimin e punës praktike, aplikative si edhe për orientimin e studentit diplomant në shfrytëzimin e literaturës relevante. <i>Referenca:</i> Ref_055 - Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor



Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Punimi final për gjithë studentët e në këtë program studimi bëhet përmes mbrojtjes së diplomës. Pika 10 dhe 11 e Procedurës së Mbrojtjes së Diplomës jep detajet e organizimit të mbrojtjes së diplomës dhe vlerësimit të punimit nga komisioni përkatës. Teza e diplomës mbrohet para një komisioni të posaçëm, i cili propozohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i FGJM. Mbrojtja e diplomës është publike. Në përfundim të çdo seance të mbrojtjes së punimeve të diplomave, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo studenti diplomant notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Ajo regjistrohet në proces-verbalin e mbrojtjes së diplomave. <i>Referenca:</i> <i>Ref_055 - Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studenti e zhvillon punimin e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi të miratuar. Udhëheqësi i diplomës është personi përgjegjës i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani i FGJM, për të drejtuar punën studimore dhe laboratorike të diplomës. Çdo student në vitin e tretë të programit të studimit Bachelor në FGJM ka të drejtën e marrjes së një teme diplome, e cila ofrohet nga Departamenti që mbulon atë program studimi. Drejtuesit e Departamenteve të FGJM krijojnë fondin e temave të diplomave sipas propozimeve të stafit akademik dhe numrit të studentëve në vitin akademik përkatës. Pas krijimit të fondit të temave të diplomave dhe udhëheqësve respektive, Drejtuesi i Departamentit i miraton ato në Dekanatin e FGJM dhe vijon me shpalljen e tyre. Studenti diplomant ka të drejtë të zgjedhë një (ose më shumë) tema preferenciale. Vendimin përfundimtar për shpërndarjen e temave të diplomave e ka Drejtuesi i Departamentit. Udhëheqësi i punimit të diplomës ka përgjegjësinë e drejtimit të punës për realizimin e punës praktike, aplikative si edhe për orientimin e studentit diplomant në shfrytëzimin e literaturës relevante. Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë, sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studneti, Në fund udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit, duke firmosur në formularin përkatës. <i>Referenca:</i> <i>Ref_055 - Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo	Ndër të tjera studentët e PS Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit" kanë të drejtë të përdorin infrastrukturën që FGJM vë në dispozicion të procesit mësimor dhe shkencor, mjediset si biblioteka, salla kompjuterësh dhe shërbime të tjera, që FGJM ofron për studentët.



jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	FGJM vë në dispozicion të studentëve të gjitha mjediset laboratorike dhe pajisjet që ata disponojnë, në shërbim të kryerjes së matjeve, analizave, si dhe asistojnë në punën laboratorike. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_049 - Informacion laboratorët DBE</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” në Fakultetin e Gjeologji Miniera, të Universitetit Politeknik të Tiranës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Shoqërohet me Suplementin e Diplomës. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_077 – Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, FGJM ruan kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Struktura kryesore e cila administron, menaxhon dhe ruan dokumentacionin e studentëve për çdo program studimi në FGJM është Sekretaria Mësimore (SM) e FGJM. Sekretaria Mësimore mban regjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve, bëhet prej Sekretarisë Mësimore në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri”. Të dhënat e studentëve ruhen përgjithnjë dhe paraqiten sipas kërkesës së të interesuarve. <i>Referenca:</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_030 – Modeli i regjistrave në Sekretarinë Mësimore</i>

	Ref_077 – Rregullore e Sekretarisë Mësimore			
Konkluzione	Në rregulloren e programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë “Bachelor” në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Do të sugjeronim: 1. Në rregulloren e programit të studimit do të ishte më efektive të tregoheshin “Rezultatet e të Nxënit – Learning outcomes” të ndara sipas kategorive: dije, aftësi, kompetenca, që fitohen me përfundimin e këtij programi studimi. 2. Të jepën argumentet pse të gjithë studentët i përfundojnë studimet me punim diplome (megjithse në Rregullore pranohen të dy mundësitë)			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e	Referuar Organigramës së Universitetit Politeknik të Tiranës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet juridike si dhe sektorin e protokollit dhe arkivës institucionale. Sektori i Burimeve Njerëzore, si pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit. UPT ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo punonjës, sipas funksioneve, duke përcaktuar dhe në kontratën individuale të punës. Bashkëlidhur me kontratën gjenden dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Handwritten signature

programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	përshkrimet e punës për secilin. Përgjegjësitë për çdo funksion janë të përcaktuara në rregulloren e FGJM dhe departamenteve si dhe në Statutin dhe Rregulloren e UPT. <i>GVJ konstaton se, duke shqyrtuar syllabuset e administruara rezulton se nuk zbatohet pika 3 e nenit 59 të Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë që titullari i lëndës/modulit duhet t'i përkasë kategorisë profesor. Në këtë program studimi janë angazhuar si titullarë lëndësh 15 doktorë shkencash dhe 8 staf akademik me diplomë "Master i shkencave".</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_008 - Rregullorja e brendshme e DBE</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore e mbuluar nga personeli akademik efektiv, për vitin akademik 2022 – 2023 është 87.06% që plotëson kërkesën sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: <i>"Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi"</i>. <i>Referenca:</i> <i>Ref_058 - Raportimi realizimit ngarkesës vjetore Pedagog Departament FGJM</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurrim, përmes thirrjeve të hapura. Shpallja e thirrjeve bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike online përmes www.upt.al (rubrika vende pune). Thirrjet shpallen edhe përmes faqeve zyrtare web të njësive kryesore dhe publikohen edhe në rrjete sociale. Statuti UPT dhe Procedura e Rekrutimit të Stafit Akademik dhe Ndihmës-akademik ka të përcaktuar kriteret e përgjithshme ndërsa njësitet bazë dhe kryesore vendosin kriteret specifike për rekrutimin e stafit të ri. Universiteti Politeknik i Tiranës rekrutimin e stafit akademik e bën referuar procedurave e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore, nenet 57, 59, 64 të "Procedura e Punësimit të Personelit PAE në UPT" dhe i bën ato publike. Procedura fillon me përcaktimin e nevojave për staf akademik prej vetë njësive bazë dhe propozimin për kriteret specifike në përputhje me nevojat, të cilat miratohen në mbledhjen e departamentit, e më pas përcillen për miratim të mëtejshëm tek Dekani, Rektori e Senati Akademik. Çdo procedurë e ndjekur më sipër dokumentohet në dosjen e personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore të UPT. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_051 - Procedura e punësimit të Personelit PAE në UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi	Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit, të mbështetur në kriteret e përgjithshme, në përputhje me kërkesat

dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	ligjore, dhe kriteret specifike sipas nevojave të Departamenteve dhe programeve të studimit që ofron, duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik bëhet në përputhje me statutin e UPT. Gjithashtu UPT ka hartuar procedura të veçanta për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Departamenti në fillim të çdo Viti akademik analizon nevojat dhe kërkesat për stafin akademik për mbulimin e lëndëve të ofruara në programin e studimit duke përpiluar një dokument të planit të ngarkesave. Pasi përcakton nevojën për staf, drejtuesi i njësisë bazë ja përcjell drejtuesit të njësisë kryesore numrin e vendeve të lira dhe kriteret për personelin akademik me kohë të pjesshme, në zbatim të rregullores përkatëse. Numri i vendeve vakante, së bashku me kriteret e nevojshme, bëhen publike në faget ëeb të FGJM dhe UPT si dhe afishohen në ambientet e FGJM (http://upt.al/images/stories/punesim/Shpallje_fgjm_Karriera.pdf). Pas një periudhë kohore 10-ditore kalendarike, kërkesat që kanë ardhur nëpërmjetshje të thirrjes shqyrtohen nga një komision i përbërë nga pesë anetare; përgjegjësi i departamentit, përgjegjës të sektorëve apo titullarë të lëndëve përkatëse. Ky komision shqyrton dosjet dhe përcakton fituesit sipas kriterëve të aplikimit. Lista me fituesit dërgohet tek njësi kryesore e cila e bën publike duke i shpallur emrat fitues në faqen web të UPT [http://upt.al/images/stories/punesim/Fituesit_fgjm_Ndihmesakademik.pdf]. Kandidatët jo fitues kanë 3-ditë kalendarike kohë për tu ankumuar. Në rast ankesash, komision është i detyruar të kthejë përgjigje të shkruar për çdo person të interesuar, brenda 5-ditëve kalendarike. Pasi përmbyllet procedura e mësipërme dhe pas miratimit në dekanat, drejtuesi i njësisë qëndrore i dërgon Rektorit listën me emrat fitues së bashku me kontratat përkatëse për firmë. <i>Referenca:</i> Ref_051 – Procedura e punesimit te Personelit PAE në UPT Ref_052 – Procedura e punesimit te Personelit PAK në UPT Ref_063 _Praktike punësimi staf akademik FGJM
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas	Angazhimi gjatë kohës së punës për secilin anëtar të stafit është e shpërndarë në të tre elementët përbërës së saj: • realizimi i procesit mësimor, • kërkimit shkencor, • transferimit të dijeve (sipas bazës ligjore në fuqi). Ndarja e ngarkesës mësimore prej drejtuesit të departamentit, për secilin anëtar të stafit akademik bëhet në përputhje me prioritetet për punën kërkimore që secili parashikon individualisht dhe në nivel Grupi Mësimor / Departamenti/Fakulteti apo Universiteti, në fillim të çdo viti akademik. Kjo çon në rritjen e kërkesës dhe të përgjegjësisë jo vetëm të pedagogëve por edhe të personelit ndihmës akademik që të sigurohet një angazhim i

natyrës specifike të programit të studimit.	përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_021 – Udhezues i Rektorati UPT për zgjedhjen e drejtuesve të grupeve mësimore</i> <i>Ref_043 - Praktika e parashikimit të ngarkesës mësimore FGJM</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UPT përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron. UPT në strukturën e vet organizative të tij ka miratuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Kjo drejtori është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet juridike si dhe sektorin e protokollit dhe arkivës institucionale [http://upt.al/burimetnjerëzore]. UPT ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas funksioneve, duke i pasqyruar në kontratën personale të punës. Bashkangjitur me kontratën është edhe përshkrimi i punës. Përgjegjësitë dhe funksionet për çdo pozicion parashikohen në Rregullore e Brendshme FGJM e të DBE, si dhe në Statutin e UPT. Një dosje të plotë, për secilin prej anëtarëve akademik të brendshëm dhe personelit ndihmës dhe administrativ, mirëmbahet në Sektorin e BNJ me të dhëna që përditësohen prej vetë stafit akademik duke plotësuar në lidhje karrierën apo titujt e fituar në kohë. [Tabelat 1 & 2, Aneksat]. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_024 - CV e stafit akademik</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas	Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të naftës dhe gazit natyror. Këto institucione vënë në dispozicion të studentëve, personel të kualifikuar për mbikëqyrjen e praktikës profesionale, i cili mbështet studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre. Universiteti Politeknik i Tiranës, angazhohet në zbatimin e politikave integruese të personelit të vet akademik, nëpërmjet formave të ndryshme të asistencës, mbështetjes për sigurimin e bazës materiale didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimit, ofrimin e mundësive për kualifikim dhe zhvillim profesional, etj. Siç parashikohet në dokumentin “Plani Strategjik 2019-2024” të UPT dhe në Planin Strategjik të FGJM-së, UPT synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një mësimdhënie bashkëkohore sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare, standardeve Europiane ESCO, deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Stafi inkurajohet të përdorë metoda të

natyrës së programit të studimit.	larmishme të mësimdhënies dhe në ndihmë të studentit në funksion të arritjes së objektivave të programit të lëndës. Edhe DBE, si pjesë e FGJM-së dhe UPT-së synonë të jetë pjesë aktive e strategjisë së UPT në përmirësimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe bashkëpunimit me studentët. <i>Referenca:</i> <i>Ref_002 – Plani Strategjik i UPT</i> <i>Ref_039 – Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore Bit-Albania</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktikat profesionale me studentët e FGJM kryhen pranë subjekteve private e shtetërore sipas fushës së studimeve të studentit. Kjo është bërë e mundur falë marrëveshjeve që UPT dhe FGJM kanë me këto subjekte sikurse janë marrëveshjet me: - Ministrinë e Infrastruktura dhe Energji - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë; - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; - Autoriteti Shtetëror për Informacinin gjeohapësinor (ASIG); - Akademia e Shkencave të Shqipërisë; - Lufthansa Industry Solutions; - Albpetrol; - Bankers Petroleum Albania; - Deloitte; - Gjeo Vjosa - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - Shërbimi Gjeologjik Shqiptar etj. Një element i rëndësishëm i koordinuar në kuadrin e praktikave profesionale është angazhimi në drejtimin e tyre të stafit më të ri akademik të DIBM, stafit ndihmës akademik si dhe ish studentët e diplomuar në programet e studimit; Bachelor, Master Shkencor dhe Master Profesional të ofruara nga DIBM të cilët punojnë në profesion. Ky kombinim ka rezultuar shumë sinjifikativ në drejtim të motivimit, njohjes së terrenit si edhe për një punësim të mundshëm në këto kompani. <i>Referenca:</i> <i>Ref_047 - Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i> <i>Ref_086 – Praktikë për Miratim shpenzimesh për pjesëmarrje në konferenca</i>
Konkluzione	<i>Në programin e studimit "Bachelor" në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit" është angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë dhe personel ndihmës akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi, nevojat dhe specifikat e programit.</i> <i>Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Por duke shqyrtuar syllabuset e administruara rezulton se nuk zbatohet pika 3 e nenit 59 të Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë që titullari i lëndës/modulit duhet</i>

	<i>t'i përkasë kategorisë profesor. Në këtë program studimi janë angazhuar si titullarë lëndësh 15 doktorë shkencash dhe 8 staf akademik me diplomë "Master i shkencave".</i> <i>Bashkëpunimi me ente të ndryshme, të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e naftës dhe gazit mundëson realizimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, vërehet që Institucioni ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave ka vënë në dispozicion ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor, Ky Fakultet ka në përdorim sipërfaqen prej 7481 m². Mësimdhënia në FGJM realizohet në dy godina: godina e re me sipërfaqe 2678 m² dhe godina e vjetër me sipërfaqe 4803 m². Mjediset në përdorim nga FGJM janë si në vijim. ▪ 12 salla leksionesh me një sipërfaqe totale prej 853 m². ▪ 21 salla seminararesh me sipërfaqe totale prej 896 m². ▪ 1 sallë për veprimtari promovuese me sipërfaqe 117 m². ▪ 24 laboratorë për lëndë të ndryshme ▪ 1 laborator informatike, në total 1080m². FGJM zotëron një laborator informatike me sipërfaqe 50.23 m². ▪ 24 mjedise të hapsirës së përbashkët me sipërfaqe 2638 m². ▪ 1199 m² për stafin akademik. Numri total i studentëve aktivë në FGJM për vitin akademik 2023 - 2024 është 1570. Raporti i sipërfaqes m²/student në mjediset e dy godinave është 4.7 m²/student. Normativa 5 m²/student, e përcaktuar për IAL e profileve inxhinierike sipa/legjislacionit në fuqi arrihet duke marrë në konsideratë pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim në nivel institucioni siç janë Biblioteka Shkencore me sipërfaqe 1587 m² dhe IGJEO (Instituti i Gjeoshkencave) me sipërfaqe 2329 m². Proporcionalisht në funksion të FGJM në këto dy godina janë 575.32 m² duke e bërë sipërfaqen totale që përdoret nga FGJM në nivel institucioni të barabartë me 7653.78 m², që i korrespondon raporti 5.08 m²/student. Lartësia e katit tavan/dyshe me ne secilen godine është

	me e madhe se 3 m, por nuk ka izolim te mire akustik, kane ndricim te mire, si edhe jane te pajisura me sisteme ngrohje-ftohje. <i>Referenca:</i> <i>Ref_064 - Relacion për infrastrukturën e FGJM</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset e FGJM që shërbejnë për realizimin e mësimin janë të pajisura pjesërisht me mjetet standarte për një klasë mësimi, Klasat e leksioneve janë të pajisura vetem pjesërisht me videoprojektorë të fiksuar në mur si dhe burime të shumëfishta të furnizimit me energji elektrike dhe lidhje me kabëll për internetin. FGJM ka në dispozicion edhe shumë ambiente laboratorike që i shërbejnë procesit mësimor por edhe atij kërkimor-shkencor. Gjithashtu momentalisht Fakulteti ndodhet në proces rikonstruksioni prandaj shumica e laboratoreve nuk janë akoma në gjendje pune. [Evidenca Nr. 100 - Leje ndërtimi]. <i>Referenca:</i> <i>Ref_049 - Informacion laboratorët DBE</i> <i>Ref_064 - Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref_100 – Leje e ndërtimit për rikonstruksionin e FGJM</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	UPT zotëron 88 laboratorë specifikë sipas moduleve dhe 12 laboratorë për informatikën, të shpërndara nëpër godinat e tij. Nga këto laboratorë, FGJM ka 15 laboratorë në dy godinat që zhvillon veprimtaritë e tij. Këto laboratorë përmbajnë pajisjet e nevojshme teknike dhe informatike për të zhvilluar laboratorët dhe praktikën me studentet por mund të përdoren gjithashtu edhe për kërkim shkencor nga stafi i FGJM. <i>Referenca:</i> <i>Ref_049 - Informacion laboratorët DBE</i> <i>Ref_064 - Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref_066 Evidenca mbi laboratorët në UPT</i> <i>Nuk është depozituar Rregullorja E përdorimit të këtyre laboratorëve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	UPT ofron 12 laboratorë informatikë të pajisur në nivel të kënaqshëm. Lëndët e Teknologjisë së Informacionit si p.sh informatika bazë apo gjuhët e programimit, mbahen nga personel që vijnë nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili ka në dispozicion 7 laboratorë modern dhe të pajisur me programe profesionale (gjuhët C, C++, Java, Python, Sinjalet, Rrjetat, Sistemet elektronike etj.). <i>Referenca:</i> <i>Ref_066 - Evidenca mbi laboratorët në UPT</i>
Konkluzione	FGJM ka në dispozicion ambiente me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit", duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësim nxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Universiteti Politeknik i Tiranës ka në dispozicion një bibliotekë shkencore qendrore për studentët e tij. Kjo bibliotekë ofron 65570 tituj dhe 75 vende leximi. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave ka gjithashtu një bibliotekë të vetën të pajisur me afro 116 tituj dhe 45 poste leximi/konsultimi. Kjo bibliotekë, ndryshe nga biblioteka qendrore, vihet në dispozicion vetëm për studentët dhe stafin e FGJM. Mund të thuhet se do ishte një ndihmesë shumë e vyer që ky fakultet të kishte në dispozicion një ambient të përshtatshëm, komod dhe modern për bibliotekën e fakultetit. Mjediset e saj mund të shërbejnë edhe si salla leximi apo studimi individual të studentëve, duke mundësuar kushte studimi optimale, etj. <i>Referenca:</i> <i>Ref_068 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref_091 – Rregullore e Bibliotekës Shkencore</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Biblioteka qendrore është e pajisur me një literature të pasur Shqiptare dhe të huaj. Biblioteka përmban tituj për fusha të ndryshme studimi dhe kjo i vjen në ndihmë studentëve të cilët kanë lëndë të ndërvarura nga fakultete të tjera. Studenti i "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit" mund të konsultojë tekste të cilët janë në dispozicion të fakulteteve të tjerë, pjesë e UPT. <i>Referenca:</i> <i>Ref_068 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka shkencore qendrore është në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik nëpërmjet infrastrukturës së saj, ajo zbaton orare efektive për studentët Praktikisht, oraret e bibliotekës pasqyrojnë dhe në kushte normale edhe tejkalojnë, oraret e zakonshme të mësimdhënies në auditor. Gjate vizites qe GVJ realizoi në mjediset e FGJM, u vërejt që për shkak të rikonstruksionit të godinës së fakultetit, biblioteka e Fakultetit nuk ishte funksionale. <i>Referenca:</i> <i>Ref_068 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref_091 – Rregullore e Bibliotekës Shkencore</i>



Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Mjediset e bibliotekave janë të pajisur me gjithë aksesoret e duhur dhe kanë kushte të favoshme për studim si për studentët ashtu edhe për stafin pedagogjik. <i>Referenca:</i> <i>Ref_068 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref_069 – Biblioteka dixhitale</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni u kërkon fakulteteve në mënyrë periodike që të parashtrojnë kërkesat për tituj dhe vëllime të reja tekstesh. Këto kërkesa shpërndahen në njësitë bazë dhe tek pedagogët. Fakulteti bën një përmbledhje të kërkesave dhe ja paraqet drejtorisë së bibliotekës ose parashikon në buxhetin e tij dhe blerjen e librave. Spektori i zhvillimit të koleksioneve dhe biblioteka angazhohen që të blejnë titujt dhe t'i vendosin në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. <i>Referenca:</i> <i>Ref_067 - Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2021-2024</i> <i>Ref_094 - Praktikë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore-bazë</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Sistemi COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services) është një tjetër burim i cili është i lidhur me bibliotekat e UPT. Ky sistem përfshin një rrjet të gjerë bibliotekash dhe shërben për krijimin e një sistemi katalogimi të përbashkët, ku përdoruesit mund të aksesojnë online secilën bibliotekë dhe të shfrytëzojnë katalogun në distancë. Sistemi COOBIS mund të aksesohet në lidhjen [https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries] Përmes COBISS, studentët mund të lidhen online me të gjithë bibliotekat e UPT, si edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë. Sistemi i bibliotekave në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik të UPT përfshin edhe Portalin e Bibliotekës Dixhitale [https://ulibrary.rash.al/] përmes të cilit shfrytëzohet literatura shkencore vendase dhe botërore. Institucioni ka bërë të mundur që secili student, apo anëtar i stafit akademik, të ketë akses tek portali informatik U-Library (https://ulibrary.rash.al/).
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të	Biblioteka e UPT punon dhe është e hapur cdo ditë jave për studentat me orare të vazhduara në përgjigje të nevojave të studentëve.



studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referenca: Ref_069 – Biblioteka dixhitale			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka qendrore ofron lidhjen me internetin me kabëll ose edhe wireless, për të mundësuar që studentët të shfrytëzojnë katalogët online apo bibliotekat online që i vihen në dispozicion. Sipas references, studentët mund të përdorin tabletin/ laptopin personal apo pajisje të tjera për t'a bërë të mundur këtë gjë. Referenca: Ref_068 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT Mjediset e bibliotekës nuk janë të pajisura me kompjutera fizik për të lehtësuar konsultimin e titujve online			
Konkluzione	Në bibliotekën mësimore të UPT dhe atë të FGjM vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Gjatë vizitës që GVJ realizoi në Institucion u vërejt që për shkak të rikonstruksionit të godinës së fakultetit, biblioteka e Fakultetit nuk ishte funksionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gën. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																																																		
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UPT disponon bazën e të dhënave, që përmban informacion mbi studentët të tilla, si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e regjistrimit në universitet, datë çrregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), datën e diplomimit etj. Këtë bazë të dhënash e plotësojnë, përditësojnë dhe e disponojnë sekretaritë mësimore të secilit Fakultet dhe Sektori i IT dhe e vënë në dispozicion të organeve drejtuese me kërkesë të tyre. Sistemi i menaxhimit informatik BIT ALBANIA përdoret nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave për këto qëllime. Përdorimin e Platformës së Sekretarisë Mësimore BIT ALBANIA. <i>Referenca:</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i> <i>Ref_030 – Modeli i regjistrave në Sekretarinë Mesimore</i> <i>Ref_039 – Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore Bit-Albania</i>																																																																																																		
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UPT dhe FGjM përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit administrojnë të dhënat jo vetëm për studentët e tij, por edhe për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ne tabelen në vijim, jepet numri total i personelit për tre vitet akademike të fundit. <table><tr><th rowspan="3">Ttitulli</th><th colspan="9">Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"</th></tr><tr><th colspan="3">Viti akademik 2021-2022</th><th colspan="3">Viti akademik 2021-2022</th><th colspan="3">Viti akademik 2021-2022</th></tr><tr><th>PA E</th><th>PA K</th><th>Raport i PAE/P AK</th><th>PA E</th><th>PA K</th><th>Raport i PAE/P AK</th><th>PA E</th><th>PA K</th><th>Raport i PAE/P AK</th></tr><tr><td>Titulli</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Lektore me Titullin Prof. Dr</td><td>9</td><td>0</td><td>9/0</td><td>7</td><td>0</td><td>7/0</td><td>5</td><td>0</td><td>5/0</td></tr><tr><td>Lektore me Titullin Prof. Assoc</td><td>9</td><td>0</td><td>9/0</td><td>9</td><td>0</td><td>9/0</td><td>10</td><td>0</td><td>10/0</td></tr><tr><td>Lektore me gradën Dr /Phd</td><td>14</td><td>0</td><td>14/0</td><td>12</td><td>0</td><td>12/0</td><td>11</td><td>1</td><td>11/1</td></tr><tr><td>Asistente me M.Sc (ne proces Dr)</td><td>2</td><td>0</td><td>2/0</td><td>5</td><td>0</td><td>5/0</td><td>5</td><td>0</td><td>5/0</td></tr><tr><td>Asistente me M.Sc</td><td>7</td><td>4</td><td>7/4</td><td>8</td><td>4</td><td>8/4</td><td>7</td><td>3</td><td>7/3</td></tr><tr><td>Totali</td><td>41</td><td>4</td><td>41/4</td><td>41</td><td>4</td><td>41/4</td><td>38</td><td>4</td><td>38/4</td></tr></table> <i>Referenca:</i> <i>Aneket: Tabela Permbledhese</i>	Ttitulli	Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"									Viti akademik 2021-2022			Viti akademik 2021-2022			Viti akademik 2021-2022			PA E	PA K	Raport i PAE/P AK	PA E	PA K	Raport i PAE/P AK	PA E	PA K	Raport i PAE/P AK	Titulli										Lektore me Titullin Prof. Dr	9	0	9/0	7	0	7/0	5	0	5/0	Lektore me Titullin Prof. Assoc	9	0	9/0	9	0	9/0	10	0	10/0	Lektore me gradën Dr /Phd	14	0	14/0	12	0	12/0	11	1	11/1	Asistente me M.Sc (ne proces Dr)	2	0	2/0	5	0	5/0	5	0	5/0	Asistente me M.Sc	7	4	7/4	8	4	8/4	7	3	7/3	Totali	41	4	41/4	41	4	41/4	38	4	38/4
Ttitulli	Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"																																																																																																		
	Viti akademik 2021-2022			Viti akademik 2021-2022			Viti akademik 2021-2022																																																																																												
	PA E	PA K	Raport i PAE/P AK	PA E	PA K	Raport i PAE/P AK	PA E	PA K	Raport i PAE/P AK																																																																																										
Titulli																																																																																																			
Lektore me Titullin Prof. Dr	9	0	9/0	7	0	7/0	5	0	5/0																																																																																										
Lektore me Titullin Prof. Assoc	9	0	9/0	9	0	9/0	10	0	10/0																																																																																										
Lektore me gradën Dr /Phd	14	0	14/0	12	0	12/0	11	1	11/1																																																																																										
Asistente me M.Sc (ne proces Dr)	2	0	2/0	5	0	5/0	5	0	5/0																																																																																										
Asistente me M.Sc	7	4	7/4	8	4	8/4	7	3	7/3																																																																																										
Totali	41	4	41/4	41	4	41/4	38	4	38/4																																																																																										

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UPT dhe FGJM sigurojnë akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues pajiset me një kod llogarie dhe fjalëkalim fillestar në mënyrë të pavarur e më pas e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Ky sistem i shërben Sekretarisë Mësimore dhe pedagogut që të bashkëveprojë me studentin për disa problematika. Studentët mund të informohen në çdo kohë pranë SM, pranë departamentit nëpërmjet sistemit on-line, të dedikuar. <i>Referenca:</i> <i>Ref_039 – Manual perdorimi platforma Sekretarisë Mësimore Bit-Albania</i> <i>Ref_077 – Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit BIT ALBANIA është një sistem modular i llojit pasiv. Pedagogu përdor sistemin për plotësimin e detyrimeve të studentëve (frekuentim, detyra/projekte kursi, hedhje notash), ndërsa sekretaria verbalizon dhe zyrtarizon procedurën, kontrollon historinë e studentit, nxjerr të dhëna sipas kërkesës, etj. Studenti nga ana e tij mund të përdorë sistemin për të bërë regjistrimin për pjesëmarrjen në provime, për plotësimin e pyetësorëve, anketave, etj. Nisur nga fakti që ky sistem nuk parashikon një modul për komunikimin interaktiv student-pedagog-sekretari, FGJM ka përdorur platformën Google Classroom. Gjithë stafi dhe studentët e FGJM janë të pajisur me adresa e-mail-i zyrtare të formatit <u>emer.mbiemer@fgjm.edu.al</u>. <i>Referenca:</i> <i>Ref_039 – Manual perdorimi platforma Sekretarisë Mësimore Bit-Albania</i> <i>Ref_062 – Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sistemi informatik BIT ALBANIA i FGJM mund të garantojë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ. Pedagogu mund të mbajë një regjistër frekuentimi javor të studentëve, i cili mund të kontrollohet në kohë reale nga sekretaria apo titullarët e institucionit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_039 – Manual perdorimi platforma Sekretarisë Mësimore Bit-Albania</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UPT disponon një faqe web në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në eeb publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin, informacion mbi organizimin akademik dhe administrativ, informacion mbi fakultetet, ciklet e studimit, programet e studimit dhe stafin akademik për çdo njësi, informacion mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, programet e shkëmbimeve studentore Erasmus+, aktivitetet e ndryshme dhe të shumta që zhvillohen në UPT përgjatë gjithë vitit, si dhe shërbimet e ofruara për studentët (https://www.upt.al/fakultete-dhe-institute) dhe (https://FGJM.edu.al/info/bachelor)

q

g

Konkluzione	<i>UPT disponon platformën BIT ALBANIA, përmes të cilës administron të dhënat e studentëve, stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</i> <i>UPT disponon një faqe web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UPT harton raporte financiare, që përmbajnë një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera. Autoriteti përgjegjës për menaxhimin në nivel institucioni dhe hartimin e raportit financiar është Administratori, në varësi të të cilit në nivel njësie qendrore janë administatorët përkatës. Administratori harton në mënyrë periodike raportin financiar të institucionit i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Në këtë analizë financiare pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit për çdo vit pasardhës, i cili realizohet në mënyrë periodike, kjo strukturë ndër të tjera harton edhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për vitin pasardhës si dhe harton buxhetin afat mesëm, i cili mbulon një periudhë tre vjeçare, çka jep mundësinë për një plan mbështetjeje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi. Si referencë mund të konsultohet projekt-buxheti afat-mesëm i institucionit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 087 Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në	FGJM ka hartuar dhe aprovuar Planin e tij Strategjik i cili është pjesë e planit strategjik të UPT. Në planin strategjik të FGJM bëhet një analizë e gjendjes aktuale dhe asaj strategjike, duke e ndarë këtë të fundit në një planifikim afatshkurtër dhe në një planifikim afatgjatë. Nga ana e institucionit (UPT dhe FGJM) vihen në dispozicion për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” të gjitha burimet njerëzore dhe asetet e nevojshme për realizimin e tij. Institucioni mbështet stafin akademik në ngritjen e tyre profesionale duke i mbështetur në pjesëmarrjet e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare apo në lidhje të marrëveshjeve bashkëpunimi me universitete të tjera ndërkombëtare.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al



bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	<i>Referenca:</i> <i>Ref_002 – Plani Strategjik i UPT</i> <i>Ref_007 – Plani Strategjik i FGJM</i> <i>Ref_094 Praktikë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore-bazë</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UPT i nënshtrohet çdo vit një auditimi të brendshëm, të kryer nga njësia e auditimit të brendshëm dhe të drejtuar nga Bordi i Administrimit. Organigrama e UPT e ka të specifikuar qartë pozicionin dhe varësinë e autoritetit të auditimit të brendshëm, i cili është nën varësinë e bordit të administrimit. Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësive të auditimit të brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të Brendshëm të Universitetit Politeknik të Tiranës. UPT kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 114/2015". Raporti financiar i cili realizohet në mënyrë periodike, publikohet çdo vit në dispozicion të publikut. Të dhënat mbi veprimtarisë financiare, prokurimet dhe buxhetet, bëhen publike në faqen zyrtare të UPT, përmes lidhjes [https://upt.al/rrethnesh/programi-i-transparences] dhe në portalin [https://u-transparenca.al/]. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_005 - Organigrama e UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV [Projekt-Buxheti], GVJ vlerëson se Institucioni raporton mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës deri në njësine kryesore dhe njësine bazë përgjegjëse për programin e studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_087 - Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV dhe takimet në Institucion, GVJ vlerëson se Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen. UPT ka burime financiare dhe kapacitete menaxhimi të qëndrueshme. Ai analizon treguesit e zbatimit të politikave financiare në mënyrë të vazhduar përmes Drejtorisë Ekonomike. Mesatarisht rreth 66% e të ardhurave financohen nga shteti dhe rreth 34% e tyre gjenerohen prej UPT. Buxheti vjetor i UPT ka pësuar rritje



posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	të vazhdueshme me 8-10 %/vit gjatë viteve të fundit. Në të ardhurat që vetë UPT gjeneron, 53% burojnë nga tarifa e shkollimit.			
Konkluzione	Referenca: Ref 088 – Tabela e të Ardhurave dhe investimeve 2021-2023			
	UPT dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për programin e studimit BSc në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit”, GVJ konstaton se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave si njësi kryesore në ofrimin e këtij programi dhe Departamenti i Burimeve të Energjisë, si njësi bazë e tij, kanë një bazë Rregullatore të mirë përcaktuar të të gjithë rrugëtimit të kandidatëve për studentë, studentëve ndjekës të programit dhe deri në diplomimin e tyre. Referuar Planit Strategjik të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, qëllimi i strategjisë si dokument themelor është të përcaktojë drejtimit, politikat dhe planet e veprimit e të menaxhimit të Fakultetit, zhvillimin e tyre në perspektivë, në përputhje me zhvillimet e vendit dhe të ekonomisë Shqiptare, prioritetet e zhvillimit dhe objektivat për çdo prioritet. Po sipas planit strategjik të FGJM, pika I.2, Misioni i FGJM është: - Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj. - Të ofrojë mundësi për të përfutur nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës - Të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal - Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

	Nisur sa më sipër, si dhe nga eksperiencia e gjatë në ofrimin e programeve të studimit që i përkasin Fakultetit të Gjeologji Minierave, GVJ shprehet se politikat dhe procedurat e mbulimit të studentëve që në hyrje dhe deri në diplomimin e tyre, janë më se të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatorë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_007 – Plani Strategjik i FGJM</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, neni 11 dhe neni 13 i saj, regjistrimet në këtë program bëhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend. Në këtë program studimi kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj. GVJ konstaton se në të gjithë bazën rregullatore të paraqitur në DVV, Kandidatët për studentë dhe studentët që ndjekin jo vetëm këtë program studimi por edhe programet e tjera që ofrohen në UPT, kanë të drejta të barabarta në ndjekjen dhe frekuentimin e programeve të studimit që ofrohen në këtë institucion. Sipas RVB, kriteret e pranimit janë të përgjithshme dhe të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon për programin e studimit BSc në 'Inxhinieri e Naftës dhe Gazit'. Kriteret vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilat veprohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta. Kriteret propozohen nga Departamenti i Burimeve të Energjisë dhe pasi shqyrtohen, miratohen në Dekanatin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe në Senatin akademik të UPT. <i>Referenca:</i> <i>Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit", neni 9, ky program studimi ka si kriter kryesor pranimi Maturën Shtetërore, si dhe të gjitha përcaktimet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Sipas nenit 13 të kësaj Rregulloreje, në këtë program studimi kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë dhe të huaj. Shtetasit e huaj duhet të përmbushin të gjitha detyrimet/kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni përkatës i Republikës së Shqipërisë si dhe detyrimet që janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe Rregulloren e UPT. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë	Për këtë kriter, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë në të cilën ofrohet programi i studimit, kanë një bazë rregullatore në të cilën janë të përcaktuara qartë, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së

kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	studentëve (III. Pranimi i kandidatëve; neni 9 i Rregullores së PS); vlerësim i dijeve dhe masa e frekuentimit të programit (IV. Zhvillimi i aktiviteteve, neni 16,17,18 i Rregullores së PS); kushtet e mbrojtjes diplomës dhe provimit të formimit (V. Mbrojta e diplomës/provimi i formimit, neni 19) Për sa i përket transferimit të studimeve apo njohjes së studimeve të mëparshme, referuar Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, kuotat për transferimin e studentëve dhe programe të dyta studimi nga brenda UPT apo edhe nga Institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik. Transferimet dhe programet e dyta të studimeve pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së dytë të semestrit të parë. Transferimet nga cikli i parë pranohen në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së linjës. <i>Referenca:</i> Ref_010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ –së, gjatë vizitës në Institucion, ju bë me dije se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, përpara fillimit të çdo viti akademik, nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës organizon takime informuese me maturantët, duke ju komunikuar atyre kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për çdo program studimi që ofron, me qëllimin e mirë informimit të çdo maturanti i cili dëshiron të jetë kandidat për student në një program të caktuar studimi. Në DVV, GVB ka paraqitur dokumentacion mbi aktivitetet informuese të zhvilluara nga Institucioni për të interesuarit që duan të ndjekin program studimi që ofrohet në UPT. Duke shfletuar këto materiale, konstatohet se synimi i institucionit është që nëpërmjet këtyre aktiviteteve të bëj të ditur - Programet e studimit që ofron - Kriteret e pranimi - Mundësitë për marrje burse - Mundësitë për mobilitet në kuadër të projekteve të ndryshme <i>Referenca:</i> Ref 031 – Aktivitete Informuese mbi programet e studimit
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave	Referuar DVV dhe dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni në kuadër të plotësimit të këtij kriteri, vërehet se nuk ka ndonjë politikë apo ndonjë kriter të veçantë për pranimin e kandidatëve me aftësi të veçantë, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.

dhe shtresave të marginalizuara.	Propozimi për kuotat e pranimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimit, vjen në mënyrë shkresore nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Pas njohjes me këtë shkresë, Rektori i UPT i kërkon Njësitë kryesore propozimet për kuotat për çdo vit akademik. Pasi merren nga çdo njësi propozimet e kuotave, bëhet miratimi i tyre në Senatin akademik të UPT dhe në Bordin e Administrimit të UPT dhe këto vendime përcillen në MAS. Sipas dokumentacionit 026 - <i>Praktika e miratimit të kuotave të pranimit konstatohet se Fakulteti i Gjeologji Minierave për vitin akademik 2024-2025, ka parashikuar kuota për kandidatët për student me statusin jetim dhe për studentët e pakicave dhe shtresave të marginalizuara (rome dhe ballkano egjiptianë). Nuk ka parashikuar kuota për personat me aftësi të kufizuar.</i> Gjithashtu konstatohet se në këtë vit akademik janë parashikuar kuota edhe për studentët nga trojet shqiptare (Kosovë; RMV; Mali i Zi; Preshevë, Bujanovc, Medvegje). <i>Referenca:</i> <i>Ref 026 – Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, deklarohet se UPT ka një politikë për dhënien e bursave, gjysmë-bursave dhe tarifave të reduktuara, për studentët në nevojë dhe studentët ekselentë. GVJ nuk gjeti në dosjen e vetëvlerësimit ndonjë dokument që të faktehet kjo politikë e këtij Institucioni apo ajo çka vetë Grupi i vlerësimit të brendshëm është shprehur duke i dhënë përgjigje këtij kriteri.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UPT harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, dhe diplomimin në programin e studimit. Të gjitha janë të parashikuara në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit.</i> <i>GVJ beson se UPT ka politika edhe për studentët në nevojë dhe për studentët me familje me probleme sociale, por në DVV mungon një dokument i tillë ku të vërtetohet kjo politikë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

P

Q

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar RVB si dhe dosjes së Vetëvlerësimit, mbështetur edhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT, GVJ konstaton se Institucioni ka informacion të plotë dhe të qartë, informacion i cili është vendosur në dispozicion të studentëve duke ju bërë me dije kushtet e kalimit në vitin pasardhës. Sipas nenit 37 të kësaj Rregulloreje, për programin Bachelor, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 50% të krediteve (30 kredite) të vitit të parë. Për programet e studimit të ciklit të parë, studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ai ka marrë jo më pak se 80 kredite. Studenti që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës ka këto të drejta dhe detyrime për lëndët jo kaluese: - I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lëndëve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim - Mund të frekuentojë lëndët për të cilat është vlerësuar mbetës dhe është i detyruar të frekuentojë lëndët për të cilat ka detyrim frekuentimin - Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit e programeve mësimore, nëse ka detyrim frekuentimin për lëndë që janë zëvendësuar në këtë plan me lëndë të reja - Duhet të paguajë tarifën e shkollimit <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se UPT, ka politikë të qartë dhe të mirë menduar për studentët të cilët duan të studiojnë në programet që ofron ky Institucion duke kërkuar transferimin e studimeve nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në vend. Kjo gjë iu pohua GVJ edhe gjatë takimeve të realizuara në vizitën në institucion. GVJ shprehet se sipas Rregullores së Zhvillimit kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 39, Universiteti Politeknik i Tiranës i ofron mundësinë të interesuarve për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në fillim të vitit akademik, brenda UPT – së apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, publike ose private, vendase ose të huaja. Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve angazhohet drejtpërdrejtë njësia bazë ose njësia kryesore, ajo njësi në të cilën është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve. Kjo Rregullore shprehet se Njësia kryesore ose njësia bazë parashikon në rregulloren e programit fushat e përafërta të studimit që lejohen për transferimin e studimeve. Në Rregulloren e programit nuk janë parashikuar fushat e përafërta të studimit që lejojnë studentët të transferojnë studimet e tyre.

	<i>Referenca:</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve që ndjekin një program studimi në UPT paraqitet në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Sipas kësaj Rregulloreje, neni 30, për të vlerësuar studentët, përdoret sistemi i vlerësimit me 10- nota. Nota 10 është vlerësimi maksimal dhe nota minimale kaluese është nota 5. Po sipas kësaj Rregulloreje, është shkruar shprehimisht se: në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë disa disiplina, vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara ose shlyerjes së modulit me pjesë. Në të dyja rastet, vlerësimi përfundimtar do të shprehet nëpërmjet një note mesatare të ponderuar, ku merret në konsideratë vlerësimi dhe kreditet për çdo pjesë të shlyer. GVJ shprehet se forma e vlerësimit të studentëve është e pasqyruar edhe në syllabusin e lëndëve që përbëjnë planin mësimor të programit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit Në syllabuset e lëndëve, forma e vlerësimit të studentëve është e ndryshme dhe lidhet me specifikën e lëndës. P.sh në syllabusin e lëndës Fizikë 1 vlerësimi për lëndën jepet si më poshtë: Parakushtet për hyrjen në provimin e lëndës: - Lënda Fizikë 1 nuk është e ndërvarur; frekuentimi i seminareve në masën 75%; frekuentimi i laboratorëve në masën 100%; dhe pranimi i relacioneve për secilën punë laboratorit të zhvilluar. Lënda vlerësohet 85% sipas provimit përfundimtar dhe 15% sipas rezultateve të kontrollit. Ndërsa tek syllabusi Vizatim Teknik Industrial dhe CAD, studenti ka disa parakushte për hyrjen në provimin e lëndës, të cilat janë: - Frekuentimi i seminareve në masën 75% - Frekuentimi i laboratorëve në masën 100% - Vlerësimi pozitiv në zgjidhjet e detyrave të kursit të cilat punohen dhe me AutoCad si punë laboratorit Lënda vlerësohet 80% sipas provimit përfundimtar dhe 20% sipas rezultateve të kontrolleve dhe detyrave.. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri e Naftës dhe Gazit</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat	GVJ konstaton se Institucioni ka parashikuar dhe zbaton kriteret dhe procedurë të qartë për studentët në lidhje me punimin e diplomës dhe procesin e diplomimit të tyre. Punimi i diplomës është përcaktuar si në

P

☞

e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregulloren e Zhvillimit Kurikular dhe të mësimdhënies në UPT, dhe më i detajuar në Rregulloren e programit. Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, në kreun V të saj, neni 19, është mirë përcaktuar Mbrojtja e diplomës/Provimi i formimit. Në këtë nen flitet për mënyrën e përgatitjes së punimit të diplomës; përcaktimin e temës së diplomës në Bachelor; Udhëheqjen e diplomës; përmbajtjen e kontroleve, ku në total parashikohen 2 kontrole; mbrojtjen dhe vlerësimin e diplomës; kriteret e diplomimit, ku është përcaktuar që studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar 175 kredite të parashikuara në planin mësimor të programit të studimit. Komisioni i provimit përbëhet nga së paku pesë anëtarë, përfaqësues të stafit akademik efektiv të Departamentit të Burimeve të Energjisë, anëtarë të cilët propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Provimi zhvillohet me shkrim dhe korrigjohet nga komisioni i provimit. Provimi vlerësohet me 5 kredite dhe vlerësimi i studentëve bëhet me notë. <i>Referenca:</i> Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, kreu V, neni 19			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua që UPT në përgjithësi dhe Fakulteti i Gjeologji Minierave në veçanti, marrin pjesë në të gjitha panairt e organizuara nga Ministria e Arsimit, por jo vetëm, për të promovuar programet që ofrohen në rang Universitetit dhe në rang Fakulteti. Sipas përfaqësuesve të zyrës së sigurimit të cilësisë, në këto takime shpërndahen broshura informuese për të gjithë të interesuarit që duan të ndjekin një program studimi në UPT. GVJ iu komunikua gjithashtu se i gjithë Institucioni është i përfshirë në promovimin e programeve që ofron por duhet pranuar që interesi për të ndjekur një program studimi në UPT ka rënë, ashtu si edhe në pothuajse të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend. Kjo rënie shikohet qartë edhe në numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi: 28 studentë të regjistruar në vitin 2022-2023, dhe po aq (28) në vitin 2023-2024.			
Konkluzione	GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve që ndjekin programin e studimit, BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, është vendosur një informacion i nevojshëm në lidhje me përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundimin e studimeve në këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ në lidhje me këtë kriter shprehet se për informimin e studentëve në lidhje me strukturën e organizimit të programit, pjesë e të cilës është edhe kohëzgjatja e tij, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave dhe Departamenti i Burimeve të Energjisë, përdorin disa rrugë dhe mënyra komunikimi. Konstatohet se ka një bazë rregullatore si të programit të studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, ashtu edhe të rregullores se zhvillimit kurikular dhe të mësimdhënies, rregullore e cila është për të gjithë programet që ofrohen në UPT. GVJ gjatë vizitës në institucion, u informua se studentët informohen që në momentin që regjistrohen në këtë program studimi në sekretarinë mësimore se si është i organizuar programi i studimit. Informacion më të hollësishëm, studentët e marrin gjatë kontakteve me pedagogët dhe mentorët e tyre.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ në dosjen e vetëvlerësimit gjen material sesi Institucioni informon studentët në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit dhe veprimtaritë formuese. Sipas dokumentacionit (Ref 095 <i>Fletë palosje informuese</i>) studentët njihen me pikat kryesore të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave që janë: - Bursa studimi për programin Erasmus + - Mundësitë e punësimit në programet që ofron ky fakultet, pjesë e të cilit është edhe BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit; - Bursa për studentët me mesatare të lartë; - mundësinë për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë; - mundësinë për të ndjekur një shkollë doktorate; - mundësitë e punësimit, etj. Ndërsa informacionin më të plotë për veprimtaritë formuese, GVJ iu tha se studenti e merr në syllabuset e lëndëve dhe sidomos në komunikimin e vazhdueshëm me pedagogun, i cili është përcaktuar nga Departamenti për një grup të caktuar studentësh. Çdo grup studentësh ka pedagogun mentor të tij. <i>Referenca:</i> <i>Ref_095 - Fletë palosje informuese</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ iu komunikua se UPT në rang Universiteti ka një sërë marrëveshesh institucionale që janë në funksion të studentëve edhe për punësimin e tyre. Konstatohet se disa prej këtyre marrëveshjeve nuk janë më funksionale dhe do sugjerohet që institucioni të gjente format dhe mënyrat për të shtuar listën e marrëveshjeve në funksion të këtij programi studimi.

	Në dokumentin 047 janë përfshirë institucionet e bashkëpunimit me të cilat UPT realizon praktikat e studentëve dhe ka mundësi punësimi. Në dokumentin e fundit të kësaj liste, paraqitet tabela me institucionet me të cilat janë lidhur marrëveshje në kuadër të Erasmus +. Në këtë tabelë janë përfshirë 34 Universitete të huaja, nga të cilat vetëm për dy institucione/Universitete janë në fuqi marrëveshjet për vitet që vijnë, konkretisht: - Universiteti of West Attica (UNIWA) i përfundon marrëveshja më 2027; - Politecnico i Torinos, i përfundon marrëveshja më 2024. <i>Referenca:</i> Ref 045 - Marrëveshjet Institucionale UPT Ref 047 - Marrëveshjet me industrinë dhe Institucione.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Siç jemi shprehur edhe më lart, në UPT ka disa mekanizma të cilat funksionojnë duke informuar studentët me gjithçka që lidhet me procesin mësimor dhe me programin e studimit. Një informacion të hollësishëm studentët kanë edhe për infrastrukturën në funksion të programit dhe bazën laboratorike në funksion të realizimit të programit. Gjatë vizitës në vend, për shkak të punimeve/rikonstruksionit që kishin filluar prej kohësh në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, GVJ nuk pati mundësi të shikonte bazën laboratorike në funksion të programit BSc Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Gjatë vizitës GVJ pa laboratorë që ishin përshtatur për këtë program studimi deri në përfundimin e ristrukturimit të godinës ku do të jenë laboratorët në funksion të programit.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Për programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, studentët e këtij programi kanë mundësi të përdorimit edhe të platformës BIT. GVJ iu tha gjatë vizitës në institucion që akses i çdo studenti në këtë platformë është i lehtë dhe realizohet duke përdorur emër përdoruesi (<i>user name</i>) dhe fjalëkalim (<i>password</i>) personal. Me përdorimin e kësaj platforme studentët njihen që në momentin që regjistrohen në programin e studimit.			
Konkluzione	GVJ shprehet se ka informacion të plotë për studentët. Për bazën laboratorike dhe infrastrukturën në funksion të këtij programi nuk shprehem dot plotësisht pasi gjatë vizitës në vend nuk u njohëm me këtë infrastrukturë laboratorike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



P

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ shprehet se Informacionin për këtë pikë e mori nga takimi me departamentin dhe me Sekretarinë mësimore. Referuar tabelës Nr. 23 (bashkangjitur RVB), ku paraqiten të dhënat për studentët e diplomuar, rezulton se për periudhën 2021-2024 numri total i të diplomuarve është 130 studentë. Sipas të dhënave në Sekretarinë mësimore, pohohet numri 130 i studentëve të diplomuar, prej të cilëve 29 janë punësuar në përputhje me programin që kanë mbaruar. Ndërsa numri i studentëve të regjistruar paraqitet në Tabelën 21 të DVV, por e konfirmuar edhe në Sekretarinë mësimore, si më poshtë: Viti akademik 2021-2022 – 40 studentë Viti akademik 2022-2023 – 28 studentë Viti akademik 2023-2024 – 28 studentë Referuar materialit të paraqitur në DVV, (Ref 044 <i>Raporti i aktivitetit mësimor Staf Departament FGJM</i>), në kreun III, pika g, Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet për çdo program studimi (viti akademik 2022-2023) për programin BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, numri i hyrjeve /numri total i të regjistruarve është 80 studentë. Ndërsa referuar tabelës në po të njëjtin material, Kreu III, pika h, të dhëna të përgjithshme mbi studentët për vitin akademik 2022-2023, paraqiten të dhënat për Programin BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, si më poshtë: BSc në Inxhinieri Naftë dhe Gazi – Viti 3 – Numri total i studentëve të regjistruar – 31 studentë – Viti 2 – Numri total i studentëve të regjistruar – 21 studentë – Viti 1 – Numri total i studentëve të regjistruar – 28 studentë <i>Referenca:</i> Ref 044 - <i>Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ shprehet se informacioni për këtë pikë në DVV është i cunguar. Po ti referohesh përgjigjes që ka dhënë Grupi i vlerësimit të brendshëm për këtë program, përgjigja për këtë kriter është marrë edhe duke pasur si referencë materialin Ref 073 (<i>Raporti i aktivitetit mësimor në nivel njësisht dhe universiteti</i>). Referuar këtij materiali, GVJ konstaton se, në këtë material është paraqitur raportim i pedagogut për aktivitetin mësimor, viti akademik 2022-2023. Ky material nuk ka lidhje me të dhënat që kërkon plotësimi i kriterit. Sipas të dhënave të paraqitura në materialin 044, për vitin akademik 2022-2023, vit në të cilën është përqendruar institucioni kur ka përgatitur këtë raport/analizë, mungojnë të dhënat për: - Numrin e të diplomuarve në Bsc Inxhinieri e Naftës dhe Gazit (III, pika G)

	- Numrin e të diplomuarve të punësuar - Numrin e të diplomuarve të punësuar në përputhje me profesionin - Numrin e të diplomuarve të regjistruar në ciklin pasardhës - Numrin e studentëve të çregjistruar - Numrin e studentëve të transferuar - Numri i studentëve të ardhur më transferim <i>Referenca:</i> <i>Ref_044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM</i> <i>Ref_073 - Raporti i aktivitetit mësimor në nivel njësisish dhe universiteti</i> <i>Minutat e vizitës në institucion</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstaton se të dhënat për studentët ruhen në Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minerave. Në këtë fakultet funksiononte sistemi i brendshëm i informacionit në formë elektronike BIT Albania. GVJ iu komunikua se këto të dhëna janë të sigurta dhe të verifikueshme për personat e autorizuar, duke pasur parasysh mos kallëzimin e të dhënave sensitive, të cilat mund të keq menaxhohen.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në DVV deklarohet se të dhënat për studentët dhe statistikën për to, janë objekt kontrolli i përvitshëm nga strukturat përgjegjëse të UPT, nga kontrolli i të cilave realizohen raportimet përkatëse në strukturat drejtuese. GVJ tërheq vëmendjen që të dhënat për studentët të jenë të plota dhe të sakta, pasi na rezulton se mungon informacioni bazik mbi to (<i>Ref 044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM</i>) <i>Referenca:</i> <i>Ref 044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër, në DVV por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua se ka Raporte analitike, mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, etj. Në materialin tip të paraqitur në DVV, (044) të dhënat nuk janë të plota dhe janë paraqitur edhe tabela të cilat nuk kanë asnjë të dhënë për këtë fakt. Referuar Raportit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, Tabelave në fund të këtij raporti, shprehemi për këtë pikë sa më poshtë: Sipas tabelës Nr. 21 cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve paraqitet - Viti akademik 2021-2022 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, janë 40 studentë me notë mesatare 7.47 - Viti akademik 2022-2023 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, janë 28 studentë me notë mesatare 7.83

	- Viti akademik 2023-2024 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, janë 28 studentë me notë mesatare 7.75 Në këtë tabelë mungojnë të dhënat për studentët e transferuar sipas viteve Sipas tabelës 23 në programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, për periudhën 2021-2024, numri total i të diplomuarve është 130; numri i të punësuarve (në përputhje me diplomën) është 29 dhe numri total i të punësuarave (jo në përputhje me diplomën) është 30. <i>Referenca:</i> Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit, Tabelat bashkëlidhur tij Ref 044 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament FGJM			
Konkluzione	GVJ shprehet se UPT ruan të dhëna bazike në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Duhet të tregohet më kujdes në të dhënat që paraqiten në raportimet e Departamenti të Burimeve të Energjisë, pasi të dhënat janë të paplota.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Raportin e vlerësimit të brendshëm, hartuesit e tij shprehen se studentët në UPT janë të përfshirë në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Ky fakt na u pohua edhe gjatë vizitës në institucion. Referuar dokumentacionit 074 (Rezultatet e zgjedhjeve për Senatit akademik), në Vendimin Nr. 22, datë 07.08.2020 “Për shpalljen e kandidatëve fitues të zgjedhjeve për anëtarë të Senatit akademik në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vërejmë se në Senatit Akademik përfaqësohen 4 studentë. GVJ pohon se studentët janë pjesë edhe e këshillave të programeve të studimit në Departamentin e Burimeve të Energjisë. Referuar dokumentit – Vendimi i DBE për ngritjen e KPS, vërehet se në miratimin e Këshillave të Programeve të Studimit, sipas shkresës Nr 24 prot, datë 12.05.2023 të Përgjegjësit të Departamentit të Burimeve të Energjisë, në përbërje të këtyre këshillave për programet e studimit

	që ofrohen në Departamentin e Burimeve të Energjisë, pjesë e të cilit është edhe programi i studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, janë edhe studentët e programit përkatës. Për programin BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, përfaqësues është studenti M.T. Gjithashtu GVJ pohon se pjesë e Grupit të vlerësimit të brendshëm të programit është dhe një studente, e cila ishte pjesë edhe e takimit që realizoi GVJ në Institucion me GVB-në. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 074 - Rezultatet e zgjedhjeve për Senatën akademik</i> <i>Ref_020 - Vendimi i DBE për ngritjen e KPS</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ shprehet se përgjigjen për plotësimin e këtij kriteri e mori në mënyrë të tërthortë gjatë vizitës në institucion, si në takimin me Grupin e vlerësimit të brendshëm, pjesë e të cilit ishte edhe studentja, ashtu edhe me strukturat e tjera të Institucionit. Në fakt, Institucioni duhet të punojë më shumë për të nxitur studentët që të japin mendime dhe propozime konkrete për atë çka duhet të rregullohet si në funksionimin si duhet të programit të studimit ashtu edhe në veprimtaritë kërkimore. Në raportin e vlerësimit flitet për funksionimin e këshillave studentorë në nivel fakulteti. GVJ shprehet se nuk paragjykon funksionimin e këtyre këshillave, por shprehet me bindje se gjatë takimit që pati me studentët e këtij programi studimi, pyetjes për funksionim e këshillit studentor, studentët u përgjigjën se këshilli studentor nuk bën aktivitete. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Minutet gjatë vizitës në UPT</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga Njësia e Sigurimit të cilësisë, GVJ-së, gjatë vizitës në Institucion, iu pohua se kjo Njësi shpërndan pyetësor për studentët duke synuar të marri prej tyre opinione në lidhje me programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Qëllimi i pyetësorit është tu japë mundësi studentëve të shprehin mendimin e tyre mbi procesin mësimor dhe personelin akademik të programit si dhe të përcjellin pranë autoriteteve të UPT shqetësime specifike. GVJ gjykon se Institucioni përdor mekanizma për të thithur mendimin e studentëve në lidhje me programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Pyetësori në vetvete ndihmon autoritetet drejtuese për të krijuar një panoramë të çështjeve apo problematikave që kërkojnë zgjidhje. Gjithashtu GVJ ju komunikua se Njësia, në praktikën e saj të punës ka edhe raportin në lidhje me pyetësorët e studentëve. Në DVV është paraqitur raporti, (Ref 060 - <i>Anketimi studentor - Pyetësori dhe raporti</i>). Ky raport është përgatitur nga Drejtoria e Sigurimit të
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të	



vlërësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Brendshëm të Cilësisë në UPT, për vitin akademik 2021-2022 (semestri I). GVJ shprehet se rubrikat që përbëjnë raportin janë të ndërtuara mirë, të detajuara, në mënyrë të atillë që Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë të mund të marrë një informacion të plotë dhe të qartë nga procesi i anketimit, për të përcjellë në Rektorat shqetësimet apo kërkesat që kanë studentët që ndjekin programet në UPT. Raporti përfshin në rubrikat e tij: - Bazën ligjore (Ligjin e Arsimit të Lartë; Kodin e cilësisë së Arsimit të Lartë) - Organizimin e pyetësorit (Qëllimi i tij; Hartimi i pyetjeve dhe kriteret e vlerësimit) - Sistemi elektronik i pyetësorit (Gjenerimi i të dhënave; anonimati i studentit) - Rezultatet e anketimit (Metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave; Pjesëmarrja në anketim) - Evidentimi i problematikave në rang institucioni - Vlerësimet sipas fakulteteve dhe programeve të studimit (Fakultetet pjesë e anketimit; përcaktimi i anketimeve të pavlefshme; kriteret e vlerësimit sipas Fakulteteve/programeve të studimit; rezultate për çdo fakultet/program studimi; problematikat dhe rekomandimet për përmirësimin e treguesve të ulët për çdo fakultet/program studimi) - Vlerësimet e pedagogëve (të dhëna të përgjithshme; rankimi i pedagogëve; rekomandimet dhe propozimet për përmirësimin e treguesve të ulët) - Vlerësimet e pedagogëve - Anekset për pyetësorin e 6 fakulteteve <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref_060 - Anketimi studentor - Pyetësori dhe raporti</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se UPT ka përfshirë dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Studentët janë pjesë e Senatit akademik, janë pjesë e Grupeve të vlerësimit të brendshëm duke sjellë frymën dhe mendimet e tyre në institucionet drejtuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ-së gjatë vizitës në institucion iu pohua se i gjithë Fakulteti i Gjeologji Minierave, së bashku me Departamentin e Burimeve të Energjisë, departamenti përgjegjës për këtë program studimi, janë në shërbim dhe në funksion të studentëve. Referuar DVV dhe Raportit të vlerësimit të brendshëm, në shërbim të studentëve janë Drejtoria e Kurikulave me 2 sektorët e saj (Sektori i Kurikulave; Sektori i procesit mësimor) dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe Alumni. Në DVV paraqitet dokumenti 032 – <i>Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës</i>, në të cilën është paraqitur një raport përmbledhës i aktiviteteve të Zyrës së karrierës për periudhën 2022-2023-2024 Më poshtë, GVJ paraqet disa nga aktivitetet e bëra nga kjo Zyrë, ku janë përfshirë studentët e UPT-së, si: - Plani kalendarik i aktiviteteve për vitin akademik si dhe Guida studentore 2022-2023-2024 - Prezantimi për fillimin e vitit akademik me studentët e vitit të parë “Bachelor” 22-23 - Zhvillohet takimi për “Internship programme of German Business” për vendet e Ballkanit perëndimor, data 28.10.2022. - Publikim në Web-in e Fakultetit nga Shoqata Sportive UPT, datë 27.10.2022 - Workshop ne Zyrën e Karrierës së bashkisë Tiranë, më datë 13.01.2022 - Përgatitje për ditën e informimit të maturantëve (2023-2024), realizuar më datë 10.01.2023 - Për publikim në faqen e Fakultetit Platforma praktika.al 10.02.2023 - Datamine – FGJM organizon takim promovues mbi programin ‘DATAMINE’, datë 18.04.2023, etj. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 032 – Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës,</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër, GVJ pohon që në funksion të studentëve të programit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe gazit janë të gjitha strukturat e Departamentit të Burimeve të Energjisë, të Fakultetit të Gjeologji Minierave dhe të krejt Universitetit Politeknik të Tiranës. Strukturat në funksion të studentëve kanë edhe bazën rregullatore të tyre. Sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimi në UPT, në nivel njësie bazë/Departamenti, bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit. Në përbërje të këtij këshilli është edhe një student i cili përzgjidhet nga Departamenti i Burimeve të Energjisë, si Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit.



	Po sipas kësaj Rregulloreje, me propozim të Drejtuesit të departamentit caktohet koordinatori i programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënit. GVJ shprehet se UPT si një institucion me përvojë të gjatë në fushën e ofrimit të programeve të studimit të të tre cikleve, ka një sistem të mirë organizuar në funksion të procesit mësimor. Rol të veçantë këtu luan edhe Sekretaria mësimore e cila me shërbimet që ofron, është në funksion të studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 020_vendimi i DBE për ngritjen e KPS</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ realizoi takim sipas agjendës, edhe me Zyrën e Karrierës. GVJ gjatë takimit ju prezantua puna e kësaj zyre. Në Raportin e vlerësimit të brendshëm, GVB shprehet se kjo zyrë shërben si urë lidhëse e Institucionit dhe shërbimeve që ofron me studentët. Siç jemi shprehur edhe më lart, pjesë e Dosjes së Vetëvlerësimit është edhe aktiviteti i Zyrës së karrierës për periudhën 2022-2023-2024. Referuar Rregullores së programit të studimit, qëllimi i këtij programi studimi është të formojë ekspertë me njohuri të mjaftueshme për të mbuluar problemet në: Shpimin e puseve në të gjitha fushat e mundshme; shfrytëzimin e vendburimeve hidrokarbure; menaxhimin e këtyre vendburimeve; nxjerrjen dhe transportin e hidrokarbureve; mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit; shfrytëzimin e vendburimeve ujore. GVJ konstaton se ky objektivi primar është një orientim për studentin në lidhje me procesin mësimor që do të ndjekë gjatë shkollimit të tij në këtë program studimi. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, neni 2.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ iu komunikua që po punohet për funksionimin dhe sistemin e ndjekjes së studentëve pas diplomimit të tyre në këtë program studimi. Ky fakt është deklaruar edhe në raportin e Vetëvlerësimit, ku GVB shprehet se: <i>...për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësori për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre. .</i>

dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sipas përfaqësueseve të Zyrës së karrierës dhe Alumni në takimin që realizuan me GVJ gjatë vizitës në vend, u deklarua se kjo Zyrë ka kontaktuar me një numër të konsiderueshëm studentësh të diplomuar, të cilët janë treguar të gatshëm për të qenë pjesë e këtij rrjeti.			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UPT si Institucion qendror ka procedura e njësi të posaçme si Zyra e Këshillimit të Karrierës, Sekretaritë Mësimore të fakulteteve, të cilat angazhohen për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ka filluar punën për gjurmimin e studentëve të tij të diplomuar dhe ka në proces hartimin e një baze të dhënash me të diplomuarit në programet e studimit që ofron FGJM</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, GVJ shprehet se për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme në funksion të mësimdhënies, UPT ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura për të ofruar standarde evropiane në programet e studimit që ofron. Në planin strategjik të UPT për vitin 2019-2024, synohet që nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes si dhe orientimit të studentëve, si dhe përmirësimit dhe krijimit të një infrastrukture të përshtatshme dhe funksionale në shërbim të tyre, të përmirësohet cilësia e shërbimeve ndaj studentëve duke krijuar një kulturë shërbimi cilësor dhe bashkëkohor. Po sipas këtij plani strategjik, për vitet 2019-2024, UPT angazhohet për përmirësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional, duke synuar paraqitje të plotë, të saktë dhe të përditësuar të informacionit për studentët që lidhet me veprimtarinë e përgjithshme të UPT-së, veçanërisht me procesin mësimor. <i>Referencë</i> Ref_002 Plani strategjik i UPT 2019-2024



Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ shprehet se Universiteti Politeknik i Tiranës është një nga Institucionet e para të arsimit të lartë në vend dhe si i tillë, ndër vite, ka kontribuar duke përgatitur inxhinierë në degët më të rëndësishme të industrisë. Staf i akademik i UPT por edhe i Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave si njësi kryesore e programit të studimit, BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, është i kualifikuar, me tituj dhe me grada dhe me përvojë në mësimdhënie. N RVB është shkruar shprehimisht se: <i>Inxhinieria e naftës dhe e Gazit është një nga degët e UPT i cili është themeluar në vitin 1951 dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave është një nga 4 fakultetet themelues të Universitetit Politeknik të Tiranës.</i> Programi është fryt i bashkëpunimit dhe menaxhimit midis të katër njësive bazë të FGJM dhe në të japin kontributin e tyre mësimdhënës dhe shumë njësi të tjera bazë të UPT. Pra, programi ofrohet nga një staf i kualifikuar në këtë fushë dhe është një tregues pozitiv për mësimdhënien dhe studentët. GVJ gjithashtu pohon se gjatë vizitës në Institucion, këtij Grupi iu tha se analiza e kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike për realizimin e këtij programi, ishte një analizë që bëhej në Departamentin e Burimeve të Energjisë.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ shprehet se gjatë vizitës në Institucion u realizua takimi edhe NJSBC dhe gjatë këtij takimi ndër të tjera u pohua që kjo Njësi realizon pyetësorë me studentët për të thithur prej tyre mendimin kritik për përmirësim të procesit të mësimdhënies por edhe shërbimeve që ju ofrohen studentëve. Kjo njësi realizon edhe një raport me të dhënat nga përpunimi i pyetësorëve të studentëve dhe këtë raport e paraqet në Dekanat duke nxjerrë pikat e forta dhe pikat e dobëta të anketimit të studentëve. Anketimi realizohet online, ku çdo student kishte mundësi plotësimi nëpërmjet adresës së tij të email. Ashtu siç është shprehur edhe në dokumentin e paraqitur në DVV, Ref 060- <i>Raport mbi anketimin studentor Viti akademik 2021-2022 (Sem I)</i> qëllimi i këtij pyetësori është krijimi i një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me Universitetin, Fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Minutat gjatë vizitës në IAL</i> <i>Ref_060 – raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 (Sem.1)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	GVJ ju pohua se Drejtoria e Kurikulave në nivel Institucioni, ka si bazë të punës së saj edhe përputhshmërinë e programit të studimit me standardet e cilësisë. Ka një Rregullore të zhvillimit kurikular dhe

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	mësimdhënies në UPT, e cila i ka të përcaktuara të gjithë praktikën që ndiqet për zhvillimin dhe menaxhimin e programeve të studimit dhe të procesit mësimor në tërësi. Siç jemi shprehur edhe më sipër, Njësia e Sigurimit të Cilësisë monitoron sigurimin e cilësisë në mësimdhënie edhe nëpërmjet pyetësorit të studentëve. Monitorimi i procesit të mësimdhënies, realizohet edhe nëpërmjet kontrolleve që bën Zyra e NJSBC për organizimin e mësimit, sidomos në pedagogët e rinj. Të gjitha format bëhen publike dhe me rezultatet e monitorimit njoftohet Departamenti si njësi bazë dhe Fakulteti si njësi kryesore. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjatë takimit me GVB por edhe me stafin akademik, GVJ arrin në konkluzionin që Institucioni nxit përmirësimin e mësimdhënies. Shembull i tillë është mobiliteti i stafit të këtij programi nëpërmjet programeve të ndryshme ndërkombëtare. GVJ, pas leximit me kujdes të planit strategjik të UPT të paraqitur në DVV, shprehet se ky plan është tepër ambicioz dhe shpreson në arritjen e objektivave të tij. Në planin strategjik 2019-2024, objektivat e Institucionit për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore janë: - Krijimi i mundësive për kualifikimin dhe specializimin e mëtejshëm, me qëllim rritjen dhe zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ - Intensifikimin e marrëdhënieve të shkëmbimit të personelit të UPT me universitetet perëndimore dhe më gjerë - Rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të rekrutimit dhe seleksionimit të personelit akademik dhe administrativ - Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të performancës dhe motivimit të personelit të UPT <i>Referencë</i> <i>Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se Institucioni ndjek politika për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Këto politika konsistojnë në monitorimin e procesit mësimor kryesisht në këqyrjen konkrete të një ore mësimi sidomos tek pedagogët e rinj, pyetësorit të studentëve, mobilitetit të stafit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ shprehet se në UPT ka një strukturë të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Referuar Organigramës së UPT, shikohet qartësisht se Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila varet nga Zv Rektori i UPT, ka në përbërje të saj Sektorin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (me dy specialistë) dhe Sektorin e Statistikës dhe Informacionit. Referuar RVB, Grupi i vlerësimit të brendshëm shprehet se pranë Departamenteve funksionojnë këshillat e programeve të studimit, Këshill që funksionon për çdo program studimit si dhe koordinatorët e programit. Në UPT funksionon Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurikulave, struktura që bashkëveprojnë me njëra tjetrën për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofrohen. Në rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minierave (FGJM), në Kreun X të saj, flitet për vlerësimin e cilësisë në rang Fakulteti. Fakulteti është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultet koordinon veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në departamente; planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit në koordinim me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT; harton në bashkëpunim me Dekanatin, planin vjetor të veprimit për përmirësimin e cilësisë dhe harton raportin vjetor të cilësisë. Gjithçka më sipër ju pohua GVJ gjatë takimit në Institucion. <i>Referenca:</i> <i>Ref 005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është funksional në UPT. Ky fakt iu komunikua GVJ gjatë vizitës në Institucion si nga përfaqësuesit e Zyrës së NJSBC, ashtu edhe nga anëtarët e GVB dhe drejtuesi i Departamentit. GVJ nisur nga DVV dhe rregullorja e programit, konstaton se: Përmirësimi i mësimdhënies; implementimi i metodave të reja në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit; rritja e vetëdijes së personelit akademik dhe e studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofrohen; mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies, janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e fakultetit dhe e Dekanatit të këtij fakulteti.

	Në Rregulloren e FGJM, në nenin 39 të saj shkruhet: <i>Organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimit në FGJM, në nivel departamenti, bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS). Ky Këshill analizon çdo propozim për ndryshim ose përmirësim të programit të studimit dhe pasi e vlerëson atë konform me objektivat formuese të programit të studimit, me kodin e Cilësisë, me Statutin e UPT-së, rregulloren e Zhvillimit Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT si dhe me të gjithë kornizën ligjore aktuale, referuar programeve të studimit, ia përcjell për miratim dhe procedim të mëtejshëm departamentit përkatës ose fakultetit për programet ndërdisiplinore. Kjo analizë shoqërohet me një raport teknik, në të cilën jepet mendimi i KPS-së për ndryshimet e propozuara.</i> Në përbërje të KPS është edhe një student. Për sa më sipër, GVJ shprehet se në FGJM janë të ngritura strukturat për përmirësimin e cilësisë, ku përfshihen studentët si pjesë e KPS. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, neni 38, 39</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti Politeknik i Tiranës, me programet që ofron i është nënshtruar disa herë procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit si atij Institucional, ashtu edhe të programeve të studimit të të dy cikleve. Besojmë dhe shpresojmë se procese të tilla janë të shëndetshme për Institucionin pasi vënë në punë mekanizmat për mirëfunksionimin e tij dhe jo vetëm. Ri-akreditimi institucional me vlerësimin maksimal, sipas vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 01, datë 07.01.2022 ‘Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Politeknik i Tiranës’, është një tregues i përputhshmërisë së shkallës së plotësisë të Standardeve Shtetërore të Cilësisë me vlerësimin në kuadër të akreditimit të këtij institucioni. Programi i studimit objekt vlerësimi BSc në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” nënshtrohet për herë të parë akreditimit të tij të vlerësimit të cilësisë. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_018 - Vendimi i Bordit për akreditimin e UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e	Ashtu siç jemi shprehur edhe më lart, në Rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minierave, në kreun X të saj janë parashikuar disa nene në funksion të vlerësimit të cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje, fakulteti është përgjegjës për procesin e mësimdhënies. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit që ofrohen në këtë Fakultet. Studenti informohet në fillim të vitit akademik, me përmbajtjen, detyrimet, metodologjinë e vlerësimit



treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	të njohurive, dijeve dhe kompetencave të cilat janë të parashikuara në syllabusin e lëndës. Departamenti zhvillon kontrolle në auditor për procesin e mësimdhënies. Kontrolle realizohen edhe nga titullari i lëndës tek personeli akademik, i cili përfshihet në mësimdhënie. Të gjitha sa më sipër janë tregues të qartë për të nxitur arritje sa më të mira në programin e studimit. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se Institucioni ka hartuar një bazë rregullatore në të cilën ka parashikuar politika për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ, në bazë të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit, mbështetur edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm si dhe vizitës dy ditore në Institucion, shprehet se programi i studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit është në mbikëqyrje dhe nën kujdesin e Departamentit të Burimeve të Energjisë (DBE), si njësi bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen e tij. Këtë pohim e mbështesim edhe në Rregulloren e Departamentit, e cila ka të përcaktuar strukturën, mënyrën e funksionimit të tij si dhe kriteret dhe procedurat për zhvillimin dhe menaxhimin e procesit mësimor. Ky Departament është i organizuar dhe i strukturuar mbi bazë të grupeve mësimore-kërkimore-shkencore, të cilat janë: - Grupi mësimor – kërkimor i menaxhimit të Burimeve të Energjisë dhe Mjedisit - Grupi mësimor – kërkimor i Inxhinierisë së Naftës, Gazit dhe Ujit Grupi mësimor –kërkimor organizon punën për hartimin e planit mësimor dhe të programeve të lëndëve, mbikëqyr respektimin e planeve dhe programeve mësimore; ndjek ecurinë e procesit mësimor për lëndët e mbuluara nga pedagogët e grupit mësimor- kërkimor; dhe në përfundim të çdo semestri raporton tek Përgjegjësi i Departamentit për realizimin e programit mësimor.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e	

vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Programi i studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit ka një koordinator programi, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat formuese të tij. Koordinatori i programit (neni 21 në Rregulloren e DBE) në detyrat e tij ka të përcaktuar sa më poshtë: - Bashkëpunon dhe koordinon aktivitete me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit në përputhje me rregulloret e DBE dhe Fakultetit - Siguron që dokumentacioni bazë i programit të studimit: plani mësimor dhe syllabuset të jenë të përditësuar në fillim të çdo viti akademik - Siguron që materialet didaktike të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme për studentët. Për gjithçka sa më sipër por edhe për detyra të tjera të cilat janë të përcaktuara në bazën rregullatore të fakultetit por edhe të Departamentit, raportohet tek Përgjegjësi i Departamentit, i cili rast pas rasti merr masat konkrete sipas problematikave të raportuara. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_008 - Rregullorja e brendshme e DBE</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, realizimi i programit mësimor, ndjekja dhe frekuentimi i tij nga studentët e çdo programi studimi, janë në vëmendjen e Departamentit të Burimeve të Energjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit. Referuar Dosjes së vetëvlerësimit të paraqitur nga GVB, në Rregulloren e Departamentit të Burimeve të Energjisë, në nenin 76 të saj, flitet për Cilësinë e mësimdhënies dhe mësim nxënies në programet e studimit. Personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve të studimit. DBE zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, duke kombinuar format e kontrollit vertikal dhe horizontal të drejtpërdrejta si: kontrole në auditor, të realizuara nga përgjegjësi i Departamentit; kontrole nga titullari i lëndës te personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie. Ky Departament garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Programi i studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, nuk është program i cili i nënshtrohet provimit të shtetit për profesionet e rregulluara.



	<i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_008 - Rregullorja e brendshme e DBE</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ iu komunikua në takimën që pati me përfaqësues të NjSBC se kjo Njësi organizon dy herë në vit sondazhe me studentët për të marrë prej tyre opinione për mbarëvajtjen e procesit mësimor, marrëdhëniet me pedagogët e lëndëve, zhvillimin e praktikave mësimore, zhvillimi e orëve laboratorike, etj. Përpunimi i pyetësorë të studentëve bëhet nga kjo Njësi dhe me rezultatet e saj njihen Dekanati i Fakultetit të Gjeologji Minierave, pjesë e të cilit është edhe Përgjegjësi i Departamentit të Burimeve të Energjisë.			
Konkluzione	GVJ shprehet se Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë, e cila është e organizuar dhe funksionon në rang Institucional monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultate të mira të të nxëniet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të	Për plotësimin e këtij kriteri, GVJ shqyrtoi një sërë dokumentesh të cilat janë në Dosjen e Vetëvlerësimit, dokumente të cilat janë cituar edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm të këtij programi si dhe dokumentin “Plani strategjik i UPT 2019-2024”. Në këtë plan strategjik janë të përcaktuara Vizioni, Misioni i UPT, ndërkombëtarizimi dhe synimet e ndërkombëtarizimit; menaxhimi institucional nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të kapaciteteve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore; menaxhimi i procesit të mësimdhënies duke synuar përmirësimin e



cilësisë së programit të studimit.	kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standardeve më të përparuara dhe reformimi në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin, vlerësimi periodik i programeve të studimit dhe akreditimi i tyre; rritja e cilësisë në praktikat profesionale dhe diversifikimi i tyre; zhvillimi i infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik, etj Po sipas planit strategjik, UPT synon përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standardeve më të përparuara. Plani i veprimit për arritjen e këtij synimi konsiston në: Plotësimin dhe modernizimin e strukturës dhe sistemit të sigurimit të cilësisë në UPT nëpërmjet ristrukturimit të qendrës së cilësisë dhe organizimit të rrjetit të cilësisë deri në nivel programi studimi; zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë në procesin e edukimit; përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë me synim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të programeve të studimit; rritjen e transparencës dhe futjen e metodës së vetëvlerësimit periodik të punës së personelit akademik si pjesë e rritjes së kulturës së cilësisë. <i>Referenca</i> Ref 002 - Plani strategjik i UPT 2019-2024, kreu IV, IV.1
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ gjatë takimit me GVB iu bë e ditur se si ishte ngritur Grupi i vlerësimit të brendshëm dhe si ishte bërë ndarja e detyrave në anëtarët e këtij grupi. Për pyetjet e ndryshme të adresuara në anëtarët e këtij grupi, GVJ mori përgjigje të qarta dhe koncize. Pasqyrimi ishte i saktë dhe vlen të theksohet që gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit të këtij programi studimi, si pikë e fortë u theksua mbështetja e personelit akademik të këtij programi për një proces sa më konkret dhe gjithëpërfshirës. Si pikë e dobët u konfirmuan oraret e zhvillimit të mësimi të studentëve, për shkak të rikonstruksionit të godinës. <i>Referenca:</i> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e	GVJ iu komunikua se përbërja e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, është përcaktuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Burimeve të Energjisë (shkresë Nr. 9 Prot., datë 27.03.2024). Në përbërje të këtij grupi është edhe një student i programit të studimit. Në urdhrin e Dekanit të FGJM Nr. 2/2024 urdhërohet ngritja e grupeve të vlerësimit të brendshëm për programet e studimit të ciklit të parë (bachelor) që ofron FGJM. Ky urdhër është i datës 26.03.2024, Nr 199 prot.



administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Referenca: Ref_019 - Urdhër i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në raportin e vetëvlerësimit, por edhe në takimin e gjatë dhe produktiv që pati GVJ me anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, rezulton se Fakulteti i Gjeologji Minierave dhe Departamenti i Burimeve të Energjisë, ka rregulluar integritetin akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve të tij. Referenca Raporti i Vlerësimit të Brendshëm			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ashti siç është pohuar edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, për sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi është vepruar njësoj si për vlerësimin në kuadër të akreditimit edhe të programeve të tjera që ofrohen në UPT të cilat kanë përfunduar vlerësimin në kuadër të akreditimit të tyre ose janë në proces akreditimi. Nuk ka ekspertizë të ekspertëve të jashtëm për këtë program studimi.			
Konkluzione	GVJ për plotësimin e këtij standardi shprehet se përgjithësisht në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë përfshihen anëtarë të personelit akademik të Departamentit, njëkohësisht edhe pedagogë të lëndëve të programit BSc në Inxhinieri e naftës dhe gazit. Bëhen përpjekje për të përfshirë edhe studentët, por sugjerojmë që përfshirja e tyre të jetë më aktive. Konfirmojmë pjesëmarrjen e një studenti në GVB në e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike	Rezulton se Institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Veprimtaritë e tilla bëhen publike dhe dokumentohen në faqen web të UPT. GVJ shprehet se nga këqyrja e faqes web të UPT, shikohet se ka një informacion të plotë për të gjithë strukturat, drejtimin akademik dhe

për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	administrativ, programet e studimit, kërkimin shkencor, bashkëpunimet ndërinstitucionale; projekte në UPT, etj. Informacioni është i aksesueshëm nga çdo individ që është interesuar për këtë institucion. <i>Referenca:</i> <i>Faqja web e UPT: https://upt.edu.al/</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në dosjen e vetëvlerësimit Institucioni ka paraqitur raportin e Anketimit studentor të cilin e ka të publikuar dhe në faqen web të UPT. Raporti për anketimin studentor është bërë për semestrin e parë, viti akademik 2021-2022. Sipas këtij materiali, me organizimin e tij, studentët janë informuar përmes email-it, ku ju është bërë e ditur koha e kryerjes së anketimit, mënyra e plotësimit dhe rëndësia e procesit. Qëllimi i këtij pyetësori është të ndihmojë në krijimin e një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me universitetin, fakultetin, programin e studimit ku ato studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal. Po sipas këtij materiali, kanë marrë pjesë në anketim 109 studentë nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ose 4.6% e tyre. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bazë të problematikave të nxjerra nga ky pyetësor, ka evidentuar për Fakultetin e Gjeologji Minierave dhe për programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit disa problematika të përgjithshme, duke bërë rekomandimet përkatëse. <i>Referenca:</i> <i>Ref 060 Anketimi studentor – Pyetësori dhe Raporti</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ shprehet se nga këqytja e materialeve që gjenden në DVV, kryesisht mbështetur edhe në informacionin e dhënë në raportin e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) për anketimin studentor për Semestrin e parë, viti akademik 2021 – 2022, për çdo Fakultet janë nxjerrë problematikat e shprehura në anketimin e studentëve. Për Fakultetin e Gjeologji Minierave është konstatuar se pjesëmarrja e studentëve në anketim është nën 5 %, konkretisht kanë marrë pjesë 4.6 % e totalit të studentëve në këtë fakultet. Gjithashtu, në raport me anketimin e mëparshëm: - është ulur vlerësimi për rekomandimin e literaturës ndihmëse në lidhje me procesin mësimor - është ulur gatishmëria për të ndihmuar studentët edhe përtej orës së mësimi

	Gjithashtu në këtë raport, DSBC shprehet se nuk janë përfshirë 23 programe studimit (8 prej të cilave janë të Fakultetit të Gjeologji Minierave), pasi numri i studentëve të anketuar është më i vogël se 60. <i>Referenca:</i> <i>Ref_060 - Anketimi studentor – Pyetësi dhe Raporti, Pika 6.2.1; 6.5</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Për ofrimin e programeve të studimit, efektiviteti i tyre, mundësia e përmirësimit dhe impakti që ka programi tek studentët, GVJ shprehet se UPT ka një bazë rregullatore të konsoliduar, në të cilën janë të përcaktuara qartë mënyrat, ofrimi dhe veprimtaria e programit të studimit. Ashtu siç është paraqitur edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së të gjithë dokumentacionit që përmban programi i studimit (plani mësimor, syllabuset, ngarkesa e pedagogëve, përputhshmëria e formimit të tyre akademik me lëndën që japin mësim). Në rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minierave, neni 38, flitet për Këshillin e Programit të Studimit (KPS). Ky këshill ngrihet në nivel departamenti dhe është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e çdo programi studimi. Këshilli analizon çdo propozim ose përmirësim të programit të studimit; harton draft propozimin për programet e reja të studimit që synohen të hapen; përgatit raportin e analizës vjetore të programit të studimit dhe ja përcjell për diskutim dhe miratim departamentit përgjegjës; analizon format e vlerësimit të studentit; etj. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ pohon se për gjitha sa jemi shprehur edhe më sipër, në UPT, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, në Departamentin e Burimeve të Energjisë, bëhen përpjekje për të informuar studentët dhe stafin akademik për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Një rol të rëndësishëm luan Zyra e Karrierës, e cila, është një nga strukturat që ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me studentët dhe problematikat e sfidat që ata hasin në përditshmërinë e tyre studentore. Sipas materialit 096 në DVV, Zyra e karrierës ka për detyrë që t’iu ofrojë studentëve mbështetje për mënyrën e marrjes së informacionit lidhur me çdo event që fakulteti zhvillon, adresimin e kërkesave dhe ankesave që studentët mund të kenë si dhe për përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve që kanë. Realizimi i aktiviteteve të bërë nga kjo zyrë është paraqitur e hollësishme në materialin e cituar, nga periudha 17.10.2022 deri në 04.04.2024 <i>Referenca</i>

	<i>Ref_096 - Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i> <i>Ref_097- Informacion specialisti i karrierës</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ka politika, qasje të mira dhe veprimtari për të bërë të mundur sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofrohen në UPT dhe konkretisht në programin e studimit BSc në Inxhinieri e Naftës dhe e Gazit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” të ofruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës (Fakulteti Gjeologji Miniera)

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ka stafin e duhur akademik për ofrimin e këtij programi studimi, shumë specifik, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë me titull dhe me gradë.
2. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit është i pajisur me personel akademik dhe ndihmës akademik, të cilët posedojnë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën profesionale për të kryer aktivitete mësimore dhe orët laboratorike në përputhje me standardet e vendosura profesionale.
3. Programi Bachelor në “Inxhinieri e Naftës dhe Gazit” konsiderohet si program me prioritet kombëtar. Studentët të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e duhura në përputhje me ligjin përfitojnë mbështetje financiare.
4. Universiteti Politeknik i Tiranës ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë të biznesit, në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.
5. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit akademik dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ndarja e veprimtarive formuese ka një raport teori/praktikë të ekuilibruar, gjë që krijon mundësi për formim të plotë të studentit për arritjen e objektivave.
6. Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe Workshop-e me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme.

Pika të dobëta:

1. Nga vizita në Institucion nuk e patëm të mundur të shikonim Laboratorët apo mjediset e tjera në ndihmë të mësimdhënies. Aparaturat dhe mjetet e nevojshme të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi nuk ishin plotësisht në funksion ose ishin të ambalazuara, për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM. Po kështu, edhe biblioteka fizike nuk ishte në dispozicion. (Standardi IV3, kriteri 8)
2. Pjesëmarrja e studenteve në anketim është 70-80% në rang Universiteti, ndërsa në rang Fakulteti është nën 5%. (Standardi VI 5, Kriteri 2)



3. Nuk realizohet anketimi i stafit në kuadër të sigurimit brendshëm të cilësisë..Standardim VI 5 Kriteri 2)

Rekomandime:

1. Mendojmë që për të rritur cilësinë, si edhe për të përmirësuar metodat e mësimdhënies duhen motivuar studentët për t'u bërë pjesë në proceset e vlerësimit dhe duhen reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre sa më saktë.
2. Institucioni duhet të ofrojë më shumë përvoja bashkëpunuese të cilat shërbejnë si në mobilitetin e stafit ashtu edhe të studentëve në programet e studimit që ofrohen
3. Sipas Planit Mësimor nuk parashikohet Praktikë Profesionale në terren fizik pranë institucioneve, sipërmarrjeve ku studentët fitojnë njohuri dhe fitojnë aftësi praktike konkrete të jetës. Në Plan praktikës i është lënë vetëm ECTS = 75 orë mësimore (mendojmë e pamjaftueshme).
4. Në rregulloren e programit të studimit do të ishte më efektive të tregoheshin "Rezultatet e të Nxënit – Learning outcomes" të ndara sipas kategorive: dije, aftësi, kompetenca, që fitohen me përfundimin e këtij programi studimi.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Oil and Gas Engineering" provided by the Polytechnic University of Tirana (Faculty of Geology and Mining"

Strengths and affirmations

1. Polytechnic University of Tirana, Faculty of Geology and Mining, has the appropriate academic staff for the provision of this very specific study program. A considerable number of them hold scientific degrees and academic titles.
2. The Bachelor study program in Oil and Gas Engineering is equipped with academic staff and academic assistants, who possess the necessary qualifications and professional experience to perform teaching activities and laboratory hours in accordance with established professional standards.
3. The Bachelor program in Oil and Gas Engineering is considered a national priority program. Students who meet the right conditions and criteria in accordance with the law receive financial support.
4. Polytechnic University of Tirana has cooperation relations with institutions, companies, business actors, in function of the implementation of the study program, in the framework of vocational training, scientific research and mobility.
5. The program structure is created based on the experience of academic staff and is approximate to similar international programs. The division of the formative activities has a balanced theory/practice ratio, which creates opportunities for full qualification of the students for achieving their learning objectives.
6. The Institution supports its academic staff to improve didactic competences, as well as encourages and motivates academic staff to further improve teaching experience by organizing various training activities, open lectures and Workshops with invited professors from different universities.

Weaknesses

1. During the visit at the Institution we were not able to see laboratories or other facilities in aid of teaching. The necessary equipment and tools suitable for the implementation of modules, theoretical and practical training and the formative objectives of the study program were not fully functioning or were packaged, due to the reconstruction of the faculty building. The physical library was not available as well.
2. Student participation in the survey is 70-80% at university level, while at the faculty level it is below 5%.



3. No staff survey in the framework of internal quality assurance is carried out

Recommendation

- 1. To increase quality, as well as to improve teaching methods, the faculty should motivate students to become part of the evaluation processes and reflect their thoughts and suggestions as accurately as possible.**
- 2. The institution should offer more collaborative experiences that serve both staff and student mobility in the study programs offered.**
- 3. According to the Learning Program, professional practice near institutions and/or enterprises, where students acquire concrete knowledge practical skills, are not foreseen. The time (ECTS = 75 hours) dedicated to practical learning in the program is not sufficient.**
- 4. The regulation of the study program should more effectively show "Learning outcomes" divided by categories: knowledge, skills, competences, that are gained with the completion of this study program.**



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X




